



KOMISIONI EVROPIAN

Delegacioni i Bashkimit Evropian në ish Republikën Jugosllave të
Maqedonisë dhe
Zyra e Bashkimit Evropian në
Kosovë*

Instrumenti i asistencës për para-anëtarësim (IPA),

**Komponenti II, Programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar
Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë - Kosova,
2010, 2011 dhe 2012**

Udhëzimet për Aplikuesit për Grante

Referenca: EuropeAid/135-229/L/ACT/MK

Afati i fundit për dorëzim të dokumentit të konceptit dhe
aplikimeve të plota:

20 janar 2014 ora 16:00 CET

* Ky përcaktim është pa paragjykim ndaj pozicioneve rreth statusit, dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 KSKB dhe opinionin e GJND mbi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës

NJOFTIM

Kjo është një Thirrje e hapur për propozime, ku të gjitha dokumentet janë dorëzuar së bashku (Dokumenti i Konceptit dhe Formulari i Plotë i Aplikacionit). Në radhë të parë, vetëm Dokumenti i Konceptit do të vlerësohet. Pas kësaj, për aplikantët që janë para-zgjedhur, do të kryhet vlerësimi i propozimit të plotë. Pas vlerësimit të propozimeve të plota, një kontroll i kualifikimit do të kryhet për ata që janë zgjedhur përkohësisht. Kualifikueshmëria do të kontrollohet në bazë të dokumenteve mbështetëse të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues dhe "Deklarata nga aplikanti 1" dhe "Deklarata nga aplikanti 2" dhe "Marrëveshja e Partneritetit" të nënshkuara dhe të dërguara së bashku me aplikacionin.

MOHIM

Duhet të theksohet se versioni në anglisht është versioni origjinal. Në rast të mospërputhjes në mes versioneve tjera gjuhësore, mbizotëron teksti i versionit në gjuhën angleze.

Përmbajtja

1. PROGRAMI PËR BASHKËPUNIM NDËRKUFITAR – ISH REPUBLIKA JUGOSLLAVE E MAQEDONISË DHE KOSOVA	4
1.1 Historiku.....	4
1.2 Objektivat e programit dhe çështjet prioritare	5
<u>Prioritetet dhe masat për Thirrje për Propozime</u>	5
1.3 <u>Alokimi</u> financiar i ofruar nga autoriteti kontraktues	6
2. RREGULLAT PËR KËTË THIRRJE PËR PROPOZIME	8
2.1 Kriteret e pranueshmërisë.....	8
2.1.1 Pranueshmëria e aplikantëve: (dmth aplikanti dhe bashkë-aplikanti)	8
2.1.2 Subjektet e Ndërlidhura	10
2.1.3 Bashkëpunëtorët dhe Kontraktorët	10
2.1.4 Veprimet e pranueshme: veprimet për të cilat bëhet aplikimi	12
2.1.5 Pranueshmëria e kostos: kostot që mund të përfshihen	17
2.2 Si të aplikoni dhe procedurat që duhet të ndjekën.....	22
2.2.1 Forma e aplikacionit	22
2.2.2. Ku dhe si të dërgoni aplikacionin	23
2.2.3 Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve	23
2.2.4 Informata të mëtejme për aplikacionin	23
2.3 Vlerësimi dhe përzgjedhja e aplikacioneve	25
2.4 Dorëzimi i dokumentacionit mbështetës për aplikacionin e përzgjedhura përkohësisht.....	29
2.5 Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.....	30
2.5.1 Përmbajtja e vendimit	30
2.5.2 Orari kohor indikativ	30
2.6 Kushtet për zbatim pasi që Autoriteti Kontraktues të jap granit.....	32
2.7 Sistemi i paralajmërimit të hershëm dhe baza e të dhënave qendror e përjashtimit.....	32
3. LISTA E ANEKSEVE	33

1. PROGRAMI PËR BASHKËPUNIM NDËRKUFITAR – ISH REPUBLIKA JUGOSLLAVE E MAQEDONISË DHE KOSOVA

1.1 HISTORIKU

Këto Udhëzime kanë për qëllim të përdoren nga ata që aplikojnë për grante në kuadër të Thirrjes 1 për Propozime për **Programin e Bashkëpunimit Ndërkufitar ndërmjet ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Kosovës * 2010-2013 të Instrumentit të Asistencës së Para - Anëtarësimit (IPA)**¹ (në **tekstin e mëtejshëm "Programi "**) dhe do të ofrojnë udhëzime strategjike për zbatimin e asistencës sipas IPA Komponenti II - " Bashkëpunimi Ndërkufitar ". Këto udhëzime janë hartuar duke ndjekur parimet e theksuara në Rregulloren e Komisionit (EC) Nr 718 /2007, e ndryshuar me Rregulloren (EU) Nr 80/2010 (në tekstin e mëtejshëm " Rregullorja e zbatimit IPA "), zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr 1085/2006 për themelimin e Instrumentit të Para -Anëtarësimit. Zbatimi i këtij programi ndërkufitar ndërmjet ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Kosovës do të mbështetet nga alokimet financiare të IPA-s për 2010, 2011 dhe 2012 (Vendimet e financimit nr. IPA / 2010/022-538; IPA/2011/022-540; dhe IPA/2012/023-656).

Ky dokument strategjik është bazuar mbi një përpjekje të planifikimit të përbashkët midis ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Kosovës, dhe është gjithashtu rezultat i një procesi të gjerë konsultimi me aktorët lokalë dhe përfituesit potencialë. Programi analizon situatën socio-ekonomike të rajonit kufitar, përcakton një strategji të përbashkët për zgjidhjen e problemeve të identifikuara dhe formulon prioritetet e përbashkëta dhe masat për zhvillim. Qëllimi i programit është të promovojë bashkëpunimin ndërmjet njerëzve, komuniteteve dhe institucioneve të zonave kufitare, me synim të nxitjes së zhvillimit ekonomik, kohezionit social dhe zhvillimit të qëndrueshëm mjedisor.

Territori i zonës² të programit për programin ndërkufitar ndërmjet ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Kosovës mbulon hapësirën prej 13,140 km² me një popullsi prej rreth 2,789,000 banorë. Gjatësia e vijës kufitare është 158.7 km me 2 pika kufitare që veprojnë në mënyrë të përhershme. Në anën e ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, zona e kualifikuar përbëhet nga tre NNTS³ niveli III rajonet⁴. Në Kosovë, zonat e kualifikuara dhe të afërta përbëhen nga tre rajone ekonomike që korrespondojnë me NNTS ekuivalent me nivelin III.

Programi zbatohet bashkërisht nga të dy vendet. Në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, institucionet përgjegjëse janë:

- Ministria e Vetëqeverisjes Lokale, përgjegjës për koordinimin e përgjithshëm të programit
- Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shkup, përgjegjës për të gjitha çështjet e kontratës dhe pagesave, është Autoriteti Kontraktues.

Në Kosovë institucionet përgjegjëse janë:

- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal përgjegjëse për koordinimin e përgjithshëm të programit

¹ Më shumë detaje rreth Programit Ndërkufitar IPA Bashkëpunimit ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë - Kosova 2010-2013 mund të gjenden në ueb faqen e strukturës operative në Kosovë në <http://mapl.rks-gov.net/> në ueb faqen e strukturës operative në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë www.mls.gov.mk dhe në faqen e internetit të Sekretariatit për Çështje Evropiane në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë <http://www.sep.gov.mk>.

² Zona e kualifikuar ndërkufitare përcaktohet në përputhje me nenin 88 të rregullores në zbatim IPA. Rajoni Qendror në Kosovë po merr pjesë në programin si një "zonë e afërt", në përputhje me nenin 97 (1) të rregullores në zbatim IPA. Zona e programit përfshinë zonën e kualifikuar dhe zonën e afërt.

³ Nomenklatura e Njësive Territoriale për Statistikat

⁴ Qeveria e ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë ka miratuar në vitin 2007 Nomenklaturat e Njësive Territoriale për Statistikat - NTES (Official Gazette N.158/2007).

- Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, përgjegjës për të gjitha çështjet e pagesave dhe kontratave është Autoriteti Kontraktues.

Zbatimi i Programit të mbikëqyret nga një Komision i Përbashkët i Monitorimit (KPM) i përbërë nga përfaqësues të institucioneve të të dy vendeve pjesëmarrëse dhe shoqërinë civile. KPM është gjithashtu përgjegjës për përzgjedhjen e projekteve që do të financohen sipas Programit.

Të dy vendet ndihmohen nga Sekretariati i Përbashkët Teknik (SPT) me seli në Kumanovë (ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë), i përbërë nga përfaqësues të të dy vendeve dhe antenës SPT gjendet në Gjilan / Gnjilane (Kosovë). SPT është organ administrativ përgjegjës për menaxhimin e programit në baza ditore, duke përfshirë mbështetjen dhe këshillat për aplikantët potencialë, si dhe përfituesve të grantit. SPT do të jetë pika kryesore e kontaktit për aplikantët për Programin, edhe pse i gjithë informacioni mund të merret nga Antena në Gjilan / Gnjilane gjithashtu.

Kjo është Thirrja 1 për Propozime të ndërmarra në kuadrin e Programit me një qëllim kryesor për të zgjedhur projektet e bashkëpunimit ndërkufitar që kontribuojnë në arritjen e objektivave strategjike të rëna dakord nga vendet pjesëmarrëse dhe të cilat bien nën prioritetet dhe masat e identifikuar . Veprimet e përbashkëta dhe projektet ndërkufitare të zbatuara në kuadër të programit duhet të kenë ndikim në situatën sociale dhe ekonomike të popullsisë , duhet të përmirësojnë menaxhimin e përbashkët dhe të bëjnë vlerësimin e burimeve natyrore dhe kulturore dhe të forcojnë imazhin dhe kohezionin e rajonit ndërkufitar dhe të nën- rajoneve .

Thirrja e tanishme për Propozime do të zbatohet nën alokimin financiar IPA BNK për 2010, 2011 dhe 2012. Ajo përfshin dy masa që synojnë mbështetjen e zhvillimit ekonomik , mjedisor dhe social. Thirrjet për propozime kanë për qëllim të funksionojnë si katalizator i veprimeve që do të nxisin bashkëpunim në të dy vendet në kuadër të programit IPA, të promovojnë hartimin e projekteve të mundshme dhe të qëndrueshme dhe të forcojnë kapacitetet administrative të përfituesve për zbatimin dhe menaxhimin e projekteve.

1.2 OBJEKTIVAT E PROGRAMIT DHE ÇËSHTJET PRIORITARE

Objektivi global i programit është të promovojë bashkëpunimin në mes njerëzve, komuniteteve dhe institucioneve të zonave kufitare, me synim të nxitjes së zhvillimit ekonomik, kohezionit social dhe zhvillimit të qëndrueshëm mjedisor.

Objektivat specifike të programit janë:

- Promovimi i zhvillimit ekonomik të zonës së programit përmes lehtësimit të vlerësimit tregtar dhe ekonomik të turistëve dhe potencialeve kulturore të tyre;
- Përkrahja e iniciativave të përbashkëta me qëllim të mbrojtjes së ambientit dhe promovimit të zhvillimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore;
- Promovimit të kohezionit social duke inkurajuar bashkëpunimin në mes qyteteve dhe komuniteteve përmes ndërtimit të partneriteteve përtej kufirit.

Prioritetet dhe masat e Thirrjes për Propozime

Këto udhëzime për Aplikantë kanë të bëjnë me Thirrjen e parë për Propozime nën Aksin 1 të Prioriteteve: *Zhvillimi ekonomik dhe social dhe promovimi i burimeve natyrore dhe kulturore*. i programit:

Veprimet e propozuara duhet të adresojnë së paku njërin nga dy masat e radhitura më poshtë në mënyrë që aplikimi të konsiderohet i kualifikueshëm:

	Masat
Masa 1.1	Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik, social dhe mjedisor
Masa 1.2	Kohezion social dhe iniciative njerëzitet tek njerëzitet

Për më tepër **qasjet metodologjike për vlerë të shtuar** si në vijim inkurajohen. Këto janë paraqitur për ti dhënë peshë vlerësimit teknik të ndërmarrë nga komisioni vlerësues (dokumenti i konceptit tabela vlerësuese, kriteret vlerësuese 1.4).

- Veprimet e zbatuara **për të inkurajuar:**
 - **Barazi gjinore dhe mundësi të barabarta;**
 - **Pjesëmarrje e barabartë e grupeve të marginalizuara;**
 - **Ndikimi në qëndrueshmërinë mjedisore;**
- Veprimet e zbatuara përmes **qasjes pjesëmarrëse, përfshirë përfshirjen e komunitetit të biznesit dhe institucionet publike.**

1.3 ALOKIMI FINANCIAR I OFRUAR NGA AUTORITETI KONTRAKTUES

Shuma e përgjithshme indikative në dispozicion në këtë Thirrje për Propozime është **3,190,000 €** (nga të cilat € 1,620,000 për ish- Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe 1,570,000 € për Kosovën).

Autoritetet Kontraktuese të Programit Ndërkufitar midis ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë - Kosovës -, Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shkup dhe Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, rezervojnë të drejtën e mos dhënies së të gjitha fondeve në dispozicion të programit në këtë Thirrje për Propozime.

Bashkimi Evropian financimi në zonat e afërta: Në rastet e justifikuara siç duhet, përqindja e fondeve në dispozicion për veprimet ose pjesë të veprimeve të zbatuara në zonat e afërta të Kosovës (shih seksionin 2.1.3 më poshtë) është e kufizuar në 20% të alokimit përkatës për Kosovën. Nën këtë Thirrje për Propozime, shuma maksimale prej 314,000 €, që i përket alokimit për Kosovën mund të caktohet për të financuar aplikimet me aktivitetet tërësisht ose pjesërisht duke u zhvilluar në zonën e afërt. Përzgjedhja e aplikacioneve me aktivitetet në zonën e afërt në të gjitha rastet do të jetë e konfirmuar nga ana e Autoriteti Kontraktues (AK). KPM do të monitorojë përqindjen e fondeve të shpenzuara në zonat e afërta në nivel të Programit për të siguruar pajtueshmërinë me rregullin e 20%.

Në rastet kur shpenzimet në fushën e afërt propozohen, aplikanti duhet të qartësojë në Formularin e Aplikimit dhe në përshkrimin e Buxhetit, aktivitetet të cilat do të kryhen në zonën afërt dhe koston që lidhen me këto aktivitete.

Klauzola e Ndërprerjes

Përfundimi i kontratave me aplikantët në nën ndarjen për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë për këtë Thirrje për Propozime është subjekt i plotësisht të kushteve të mëposhtme:

- *Hyrja në fuqi e Marrëveshjes së Financimit ndërmjet Komisionit Evropian dhe ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë në lidhje me këtë Program Ndërkufitar në kuadër të Komponentit II IPA-s për vitin 2012.*

Duke dërguar një propozim, aplikantët e pranojnë këtë fakt dhe pranojnë që Autoriteti Kontraktues nuk do të jetë përgjegjës për asnjë dëmtim çfarëdo qoftë duke përfshirë, pa u kufizuar në, dëmet ose shpenzimet e bëra nga aplikantët në përgatitjen dhe dorëzimin e aplikimit të tij / saj në çfarëdo mënyre që ka të bëjë me mos hyrjen eventuale në fuqi të Marrëveshjes Financiare ndërmjet Komisionit Evropian dhe ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë lidhur me këtë Program Ndërkufitar në kuadër të Komponentit II IPA për vitin 2012.

Përfundimi i kontratave me aplikantët në nën ndarjen për Kosovën për këtë Thirrje për Propozime është subjekt i plotësimit të kushteve të mëposhtme:

- Hyrja në fuqi e Marrëveshjes së Financimit ndërmjet Komisionit Evropian dhe Kosovës në lidhje me këtë Program Ndërkufitar në kuadër të Komponentit II IPA-s për vitin 2012.

Duke dërguar një propozim, aplikantët e pranojnë këtë fakt dhe pranojnë që Autoriteti Kontraktues nuk do të jetë përgjegjës për asnjë dëmtim çfarëdo qoftë duke përfshirë, pa u kufizuar në, dëmet ose shpenzimet e bëra nga kërkuesi në përgatitjen dhe dorëzimin e aplikimit të tij / saj në çfarëdo mënyre që ka të bëjë me mos hyrjen eventuale në fuqi të Marrëveshjes Financiare ndërmjet Komisionit Evropian dhe Kosovës lidhur me këtë Program Ndërkufitar në kuadër të Komponentit II IPA për vitin 2012.

Madhësia e granteve (kontributi i BE-së)

Çdo grant i dhënë në bazë të këtij programi duhet të bie në mes të shumave minimale dhe maksimale në vijim, siç është paraqitur më poshtë.

Masa	Madhësia e Grantit në Dispozicion (€)
Masa 1.1: Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik, social dhe mjedisor	Shuma Minimale: 80,000
Masa 1.2: Kohezion social dhe iniciative njerëzitet tek njerëzitet	Shuma Maksimale: 250,000

Një veprim që zbatohet në të dy vendet do të përbëhet nga dy grante: një i dhënë në ish- Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe një në Kosovë. Kështu, aplikimi (propozimi i projektit) do të ketë dy buxhete të veçanta për kontributin financiar i cili kërkohet nga secili vend pjesëmarrës (për çdo grant) .

Çdo grant që kërkohet nga kjo Thirrje për Propozime duhet të bie në mes të përqindjes minimale dhe maksimale të mëposhtme të shpenzimeve të pranueshme të veprimit :

- PËRQINDJA MINIMALE: 60% e shpenzimeve të përgjithshme të pranueshme të veprimit .
- PËRQINDJA MAKSIMALE: 85% e shpenzimeve të përgjithshme të pranueshme të veprimit (shih gjithashtu Seksioni 2.1.4).

Bilanci - bashkë - financimi prej minimum 15 % të buxhetit të përgjithshëm për grant individual (dmth. diferenca midis kostos së përgjithshme të veprimit dhe shumës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktues) duhet të financohet nga aplikuesit apo burimet e partnerëve, ose nga burime të tjera përveç buxhetit të Bashkimit Evropian apo të Fondit Evropian të Zhvillimit.

Në veçanti për këtë Thirrje:

- Bilanci - bashkë - financimi prej minimum 15 % të buxhetit të përgjithshëm për grant individual (dmth. diferenca midis kostos së përgjithshme të veprimit dhe shumës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktues) duhet të financohet nga aplikuesit apo burimet e partnerëve, ose nga burime të tjera përveç buxhetit të Bashkimit Evropian apo të Fondit Evropian të Zhvillimit⁵.
- Bilanci - bashkë-financimi prej maksimum 15% për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë do të mbulohet nga Ministria e Vetëqeverisjes Lokale. Në rast se aplikantët zgjedhin të bashkë-financojnë % më të lartë se 15% të cilën Ministria do të mbulojë, aplikanti duhet të bashkë-financoj dallimin nga burimet vetanake.

2. RREGULLAT PËR KËTË THIRRJE PËR PROPOZIME

⁵ Kur një grant i financuar nga Fondi i Zhvillimit Evropian, çdo herë që përmendet financimi i Bashkimit Evropian duhet të kuptohet si iu është referuar financimit nga Fondi Evropian i Zhvillimit

Këto udhëzime përcaktojnë rregullat për paraqitjen, zgjedhjen dhe zbatimin e veprimeve të financuara nën këtë Thirrje , në përputhje me dispozitat e Udhëzuesin Praktik për të kontraktuar procedurat për veprimet e jashtme të BE-së, që është i aplikueshëm për Thirrjen aktuale (në dispozicion në internet në këtë adresë: http://ec.europa.eu/europeaid/work/procedures/implementation/index_en.htm).

2.1 KRITERET E PRANUESHMËRISË

Janë tre grupe të kriterëve të pranueshmërisë, lidhur me:

(1) Aktorët:

- Aplikuesi, dmth, entiteti që ka dorëzuar formën e aplikacionit (2.1.1),
- nëse ka, bashkë - aplikantë (ues) (**ku nuk specifikohet ndryshe aplikanti dhe bashkë-aplikuesit (sve) këtu e tutje së bashku do t'u referohet si " aplikantët "**) (2.1.1),
- dhe, nëse ka, **entitet të ndërlidhur** të aplikuesit dhe / ose bashkë-aplikuesit. (2.1.2);

(2) veprimet:

Veprimet për të cilat një grant mund të jepet (2.1.5)

(3) Shpenzimet: llojet e kostos që mund të merren parasysh në përcaktimin e shumës së grantit (2.1.6)

2.1.1 Pranueshmëria e aplikantëve: (dmth. Aplikanti dhe bashkë-aplikuesit)

Aplikanti

(1) Në mënyrë që të jenë të pranueshëm për një grant, aplikantët duhet :

• të jenë persona juridikë (individët nuk janë të pranueshëm , as aleancat joformale ose iniciativat pa status ligjor) të regjistruar të paktën dy (2) vjet para shpalljes së Thirrjes **dhe**

• t'i përkasin njëres nga kategoritë e mëposhtme :

- Autoriteteve të qeverisjes vendore;

- Qendrave rajonale të zhvillimit dhe agjencive, (përgjegjëse në nivel rajonal ose komunal, në Kosovë Agjencitë Rajonale për Zhvillim nuk kanë të drejtë të aplikojnë), (p.sh. për administrimin e parqeve natyrore, drejtorive pyjore , institucioneve kulturore);

- Zyrat lokale të punës;

- Organizatat e shoqërisë civile

- Shoqatat profesionale

- Odat ekonomike;

- Agjencitë ose organizatat publike;

- Ndërmarrjet publike (vini re se për këtë skemë të Grantit kompanitë private nuk janë të pranueshme, NVM-të mund të përfitojnë në mënyrë indirekte nga kjo Thirrje për Propozime përmes odave ekonomike),

- Universitetet, shkollat, institucionet arsimore dhe kërkimore , **dhe**

• të jenë jo fitimprurëse⁶ me qëllim të kësaj Thirrje për Propozime, **dhe**

• të jenë vendas⁷ të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë , Kosovës, të një shteti anëtar të Bashkimit Evropian , të vendeve tjera përfituese të IPA-s , një vend që është përfitues i Instrumentit të Fqinjësisë Evropiane dhe Partneritetit të (ENPI), ose një shtet anëtar i Zonës Ekonomike Evropiane, me përjashtim të organizatave ndërkombëtare (ndër- qeveritare), **dhe**

• aplikanti kryesor të jetë i regjistruar ose akredituar⁸ në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë , kur të aplikon për ndarjen caktuar për ish- Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe të jetë i regjistruar ose i akredituar në Kosovë kur të aplikoj për ndarjen caktuar në Kosovë; aplikanti kryesor duhet të ketë qenë

⁶ Profiti është i definuar si - në rastin e një granti për një veprim, një tepriçë e të të ardhurave mbi shpenzimet e bëra nga përfituesi kur kërkesa është bërë për pagesën përfundimtare. Shuma totale dhe tarifa fikse duhet të vendoset në mënyrë që të përjashtoj a priori një fitim.

⁷ Kombësia e tillë të jetë e përcaktuar në bazë të statutit të organizatës e cila duhet të demonstrojë se është themeluar nga një instrument i qeverisur nga ligji kombëtar të vendit në fjalë. Në këtë aspekt, çdo person juridik statuti i të cilit është themeluar në një vend tjetër nuk mund të konsiderohet një organizatë lokale e pranueshme, madje edhe në qoftë se statuti është i regjistruar në nivel lokal ose është arritur një "Memorandum i Mirëkuptimit".

⁸ Përfituesit udhëheqës do të jenë të vendosur në vendin përfitues pjesëmarrës përkatës, sipas kuptimit të dispozitave të nenit 96 (3) të Rregullores së IPA (EC) Nr 718/2007 e ndryshuar nga Rregullorja (BE) Nr 80/2010.

operacional për së paku dy (2) vite para afatit të fundit për dorëzim në këtë Thirrje për Propozime; **dhe**

- të jetë drejtpërdrejt përgjegjës për përgatitjen dhe menaxhimin e veprimit me bashkë- aplikantët, e jo duke vepruar si një ndërmjetës , **dhe**

Ju lutem vini re se partitë politike nuk kanë të drejtë, as si aplikantë e as si partnerë.

(2) Aplikantët potencial nuk mund të marrin pjesë në Thirrjet për Propozime ose të u jepen grante në qoftë se ata janë në ndonjë nga situatat të cilat janë të listuara në nenin 2.3.3 të Udhëzuesit Praktik për të kontraktuar procedurat për veprimet e jashtme të BE-së (në dispozicion në adresën e mëposhtme të internetit: http://ec.europa.eu/europeaid/ëork/procedures/implementation/index_en.htm);

(3) Në mënyrë që të jenë të pranueshëm për një grant, aplikantët **nuk duhet** të kenë konflikti të mundshëm interesi me Strukturat e Përbashkëta të Programit (Komisioni i Përbashkët i Monitorimit, Komisioni i Përbashkët Drejtues, Sekretariati i Përbashkët Teknik) dhe Strukturat Operacionale (Ministria e Vetëqeverisjes Lokale në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në Kosovë). Nëse shfaqet një situatë e tillë gjatë realizimit të kontratës, përfituesi duhet menjëherë të informojë Autoritetin Kontraktues. Në Pjesën B nenin 8 i formularit të aplikimit për grant ("Deklarata nga aplikanti"), aplikanti duhet të deklarojë se vetë ai, bashkë - aplikanti dhe entiteti i ndërlidhur nuk janë në asnjë nga këto situata.

Nëse i jepet kontrata e Grantit, aplikanti do të bëhet Përfituesi i identifikuar si koordinator në Shtojcën G (kushtet e veçanta). Koordinatori është bashkë-biseduesi kryesor i Autoritetit Kontraktues . Ai/ajo përfaqëson dhe vepron në emër të cilitdo bashkë- përfituese tjetër (nëse ka) dhe të koordinojë hartimin dhe zbatimin e Veprimit.

Bashkë - aplikanti (tët) (të quajtur më parë "partnerët")

Aplikantët e kualifikuar për BNK të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe të Kosovës (vendet në të cilat Thirrja është shpallur dhe veprimi do të kryhet), duhet të veprojnë së bashku me të paktën një (1) bashkë-aplikantë vendor (të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë apo Kosovës). Bashkë - aplikanti (tët) marrin pjesë në hartimin dhe zbatimin e veprimit, dhe kostot që ata kanë bërë janë të pranueshme në të njëjtën mënyrë si ato të shkaktuara nga aplikantët e BNK.

Bashkë- aplikanti(tët) duhet të plotësojnë kriteret e pranueshmërisë që zbatohen sikur për vetë aplikantin, përveç që ata nuk kanë nevojë të jenë të regjistruar ose të akredituar në Kosovë ose në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, përkatësisht dhe kjo mund të jetë një lloj i veçantë i organizatës së tillë si organizatë ndërkombëtare(ndër- qeveritare), të parashikuara në nenin 43 të Rregullave Zbatuese të Rregullores⁹ Financiare të KE-së .

Bashkë- aplikanti (tët) duhet të nënshkruajë Mandatin në Pjesën B nenin 4 të formularit të aplikimit për grant. Nëse i është dhënë kontrata e Grantit, bashkë-aplikant(tët), (nëse ka), do të bëhet përfitues në Veprim (së bashku me Koordinatorin).

2.1.2 Subjektet e Ndërlidhura (kategori e re e subjekteve në grantet e BE-së)

Subjektet e Ndërlidhura

Aplikanti dhe bashkë - aplikanti (tët) e tij mund të veprojnë me subjekte të ndërlidhura

Vetëm subjektet e mëposhtme mund të konsiderohen si subjekte të ndërlidhura me aplikantët dhe / ose me bashkë - aplikantët:

⁹ Organizatat ndërkombëtare janë organizata ndërkombëtare të sektorit publik të themeluara nga marrëveshjet ndërqeveritare, si dhe agjencitë e specializuara të themeluara nga ana e tyre: Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (KNKK) dhe Federata Ndërkombëtare e Kryqit të Kuq Kombëtar dhe Shoqatat e Gjysmëhënës së Kuqe njihen edhe si organizata ndërkombëtare.

(i) subjektet juridike së bashku duke formuar një subjekt, duke përfshirë edhe ato që janë krijuar posaçërisht për qëllime të zbatimit të veprimit. Në këtë rast, subjekti që rezulton mund të aplikoj si një aplikant ose bashkë-aplikantë, ndërsa subjektet e tjera si subjekte të ndërlidhura.

(ii) subjektet juridike që kanë një lidhje me aplikantin, veçanërisht një lidhje ligjore apo kapitale, e cila as nuk është e kufizuar në veprim e as nuk është krijuar për të vetmin qëllim të zbatimit të tij, me kusht që ata të plotësojnë kriteret e pranueshmërisë dhe të mos-përrjashtuara të një aplikanti .

Nëse aplikantëve u është dhënë një kontratë, subjektet e tyre të ndërlidhura nuk do të jenë përfituese të Veprimit dhe Nënshkrues të Kontratës. Megjithatë, ata do të marrin pjesë në hartimin dhe në zbatimin e Veprimit dhe kostot që shkaktohen (duke përfshirë edhe ato të shkaktuara për Kontratën e Zbatimit dhe Përkrahje Financiare ndaj palëve të treta) mund të pranohen si të kosto të pranueshme, me kusht që ato janë në përputhje me të gjitha rregullat përkatëse tashmë të zbatueshme për Përfituesin (it) sipas kontratës së Grantit.

Subjektet e ndërlidhura **duhet të plotësojnë respektivisht kriteret e pranueshmërisë** që zbatohen si për aplikantët edhe për bashkë-aplikantët.

Subjektet e ndërlidhura duhet të nënshkruajnë deklaratën e subjektit (eve) të ndërlidhura në Pjesën B seksioni 5 i formularit të aplikimit për grant.

2.1.3 Bashkëpunëtorët dhe Kontraktorët

Subjektet e mëposhtme nuk janë aplikantë e as subjekte të ndërlidhura, dhe nuk kanë nevojë të nënshkruajnë "Mandatin" ose "Deklaratën e 'Subjekteve të ndërlidhura':

• Bashkëpunëtorët

Organizatat e tjera mund të jenë të përfshira në veprim. Bashkëpunëtorët e tillë luajnë një rol të qartë në veprim, por mund të mos marrin fonde nga granti, me përjashtim të mëditjes ose shpenzimeve të udhëtimit. Bashkëpunëtorët nuk kanë nevojë të plotësojnë kriteret e referuara në seksionin 2.1.1. Bashkëpunëtorët duhet të përmenden në Pjesën B seksionin 6 -

'Bashkëpunëtorët e Aplikuesit që marrin pjesë në Veprim' - të Formularit të Aplikimit për Grant.

• Kontraktorët

Përfituesit të granteve dhe subjekteve të tyre të ndërlidhura u lejohet dhënia e kontratave. Bashkëpunëtorët ose subjektet e ndërlidhura nuk mund të jenë gjithashtu edhe kontraktorë të projektit. Kontraktorët janë subjekt i rregullave të prokurimit të përcaktuara në Shtojcën IV të kontratës standarde të grantit.

• Nën-përfituesit e granteve

Përfituesit e granteve mund të japin mbështetje financiare (nën-grante) për palët e tretë (nën-përfituesit e granteve). Këto subjekte nuk janë as subjekte të ndërlidhura as bashkëpunëtorët e as kontraktorë. Megjithatë, ata janë subjekt i rregullave të kombësisë dhe të origjinës të përcaktuara në Shtojcën IV të kontratës standarde të grantit.

2.1.4 Koncepti i Aplikantit dhe Aplikantit Kryesor Funkcional për secilin propozim

Çdo propozim duhet të ketë dy aplikantë ndërkufitarë, një që aplikon për fonde nga alokimi për ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe tjetri që aplikon për fonde nga alokimi për Kosovën, duke vepruar në partneritet.

Aplikantët (A1 dhe A2) duhet të nënshkruajnë dhe të vendosin datën e Marrëveshjes së Partneritetit (Pjesa B, Seksioni 8 i Formularit të Aplikimit për Grant).

Ky partneritet **nuk do të pranohet** kur themelohet në mes të operatorëve që i përgjigjen emrit të njejtë dhe që i përkasin të njëjtës organizatë amë, pavarësisht nga fakti se ata janë të vendosur në secilin prej dy vendeve pjesëmarrëse të pranueshme.

Në bazë të dispozitave të nenit 96 (3) të Rregullores së Zbatimit IPA 718/2007, Aplikanti 1 dhe Aplikanti 2 do të marrin përgjegjësitë e mëposhtme për pjesën e vendit të tyre përkatës ku zhvillohet veprimi:

- a) ai/ajo do të parashtrijë një marrëveshje me bashkë-aplikantët e projektit, subjekteve të ndërlidhura (nëse ka) në mënyrë që të garantojnë menaxhim të shëndoshë financiar të fondeve të IPA-s të ndara për veprimin, duke përfshirë masat për kthimin e shumave të paguara padrejtësisht;
- b) ai/ajo do të jetë përgjegjës për sigurimin e zbatimit të të gjithë veprimit (në anën e tij/saj të kufirit);
- c) ai/ajo do të jetë përgjegjës për transferimin e kontributit të Komunitetit (fondet IPA) tek bashkë-aplikanti (tët) dhe subjektet e ndërlidhura (nëse ka);
- d) ai/ajo do të sigurojë që shpenzimi i paraqitur nga bashkë-aplikanti (tët) dhe të subjekteve të ndërlidhura (nëse ka) është paguar me qëllim të zbatimit të veprimit dhe korrespondon me aktivitetet e dakorduara mes aplikantëve / bashkë-aplikantëve subjekteve të ndërlidhura (nëse ka).

Aplikanti 1 dhe Aplikanti 2 nga të dy vendet pjesëmarrëse duhet të sigurojnë një koordinim të ngushtë midis tyre, në zbatimin e veprimit.

Para dorëzimit të projekt propozimit, aplikantët do të emërojnë në mes tyre një **Aplikant Kryesor Funkcional**, i cili është përgjegjës për:

- o Koordinimin e përgjithshëm të aktiviteteve të projektit në të dyja anët e kufirit;
- o Organizimin e takimeve të përbashkëta me të gjithë aktorët e projektit (aplikantët, bashkë-aplikantët, subjektet e ndërlidhura), shkëmbimin e rregullt të informacionit dhe korrespondencës;
- o Raportimi tek Sekretariatit i Përbashkët Teknik (SPT) dhe Autoriteteve Kontraktuese në përparimin e përgjithshëm të projektit.

Nëse u jepet kontrata e Grantit, aplikantët (Aplikanti 1 dhe Aplikanti 2) do të bëhen Përfituesit e identifikuar si Koordinatorët në Shtojcën G. Koordinatori është bashkëbiseduesi kryesor i Autoritetit Kontraktues, përkatësisht në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë ose në Kosovë. Ai/ajo përfaqëson dhe vepron në emër të ndonjë Përfituesi tjetër (nëse ka) dhe koordinon hartimin dhe zbatimin e pjesës përkatëse të Veprimit, përkatësisht në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë ose në Kosovë.

2.1.5 Veprimet e pranueshme: veprimet për të cilat mund të bëhet një aplikim

Definicioni:

Një veprim (ose projekt) përbëhet nga kjo strukturë e aktiviteteve.

Veprimi duhet të përfshijë bashkëpunimin ndërkufitar në mënyrë që të jetë i pranueshëm, pra duhet që:

- të zhvillohet në zonën e programit;
- të ketë efekt në të dy vendet, ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe në Kosovë pjesë të zonës së programit;
- të parashikojë bashkëpunim të dy aplikantëve ndërkufitarë (A1 dhe A2) në **të paktën** një prej katër mënyrave në vazhdim:
 - o Zhvillim i përbashkët i projektit në dizajnimin e veprimit, plotësimin e formularit të aplikimit, duke përfshirë buxhetin;
 - o Financim i përbashkët: aktivitete financohen nga buxhetet e aplikantëve;
 - o Stafi i Përbashkët: Stafi në të dyja anët e kufirit, vepron si një ekip i projektit;
 - o Zbatimi i përbashkët: aplikantët bashkërisht koordinojnë aktivitetet e tyre përtej kufirit

Kohëzgjatja:

Kohëzgjatja fillestare e planifikuar për një veprim nuk mund të jetë **më e ulët se 12 muaj as të tejkalojë 24 muaj.**

Sektorët ose temat

Aplikantët do të dorëzojnë aplikimet për veprime që bien të paktën në një nga dy (2) masat prioritare të renditura më poshtë në mënyrë që aplikimi të konsiderohet i pranueshëm.

NB : Ju lutem vini re se disa veprime mund të kombinojnë të dy masat prioritare , por në rast të tillë aplikantët duhet të tregojnë në faqen e parë të propozimit masën më të rëndësishme nga dy prioritet e cila është e mbuluar nga veprimi:

MASA 1.1 - Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, social dhe mjedisor

Objektivi specifik i kësaj mase është të mbështesë iniciativat e përbashkëta që synojnë nxitjen e zhvillimit ekonomik të zonës së programit dhe mbrojtjen, nxitjen dhe menaxhimin e ekosistemeve të ndjeshme dhe trashëgimisë kulturore .

Kjo masë do të fokusohet kryesisht në veprime që mbështesin zhvillimin e infrastrukturës në shkallë të vogël , planet strategjike , praktikat e mira dhe aktivitetet e përbashkëta për të stimuluar rritjen ekonomike, për të inkurajuar ruajtjen e mjedisit, mbrojtjen dhe menaxhimin dhe për të përmirësuar kushtet socio - ekonomike të banorëve të zonës së programit.

MASA 1.2 – Kohezioni social dhe iniciativat njerëzit tek njerëzit

Objektivi specifik i kësaj mase është të mbështesë iniciativat e përbashkëta që synojnë nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe social nëpërmjet iniciativave njerëzit-për-njerëz dhe institucioni-për-institucion.

Veprimet njerëzit-për-njerëz do të synojë drejtpërdrejtë shoqërinë civile dhe pritet që të ngrisin, të lehtësojnë dhe forcojnë bashkëpunimin në mes të komuniteteve dhe organizatave lokale, të tilla si OJQ-të, dhe për të inkurajuar këta aktorë të angazhohen në partneritete ndërkufitare

Lokacioni

Veprimet duhet të kenë si përfitues përfundimtarë popullsinë e zonës së programit dhe aktivitetet e tyre duhet të zhvillohet kryesisht¹⁰ në këtë fushë. Zona e programit përbëhet nga njësitë e mëposhtme të qeverisjes lokale të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Kosovës.

Ish Republika Jugosllave e Maqedonis	Kosova	
Zona e pranueshme	Zona e pranueshme	Zona e afërt
<p>Rajoni Polog përfshinë 9 komuna:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gostivar, - Vrapciste, - Mavrovo dhe Rostusa, - Tetove, - Bogovinje, - Brvenice, - Zeline, - Jegunovce, dhe - Tearce; <p>Rajoni i Shkupit përfshinë 17 komuna:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Aracinove, - Cucer-Sandevo, - Ilinden, - Petrovec, - Sopiste, - Studenicani, - Zelenikovo. <p>Qyteti i Shkupit është një njësi administrative dhe gjithashtu përfshinë 10 komuna:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Aerodrom, - Butel, - Cair, - Centar, - Gazi Baba, - Gjorce Petrov, - Karpos, - Kisela Voda, - Saraj, - Suto Orizari; <p>Rajoni Veri Lindor përfshinë 6 komuna:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kratovo, - Kriva Palanka, - Kumanovo, - Lipkovo, Rankovce dhe - Staro Nagoricane. 	<p>Rajoni Ekonomik Lindor (zona e <i>pranueshme</i>), që përbëhet nga këto komuna:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gjilan; - Kamenicë, - Viti, - Novoberd, - Ferizaj, - Kacanik, - Shterpce, - Hani i Elezit, - Ranilug, - Partes, - Kllokot. <p>Rajoni Ekonomik i Jugut (zona e <i>pranueshme</i>), që përbëhet nga këto komuna:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Prizren, - Suhareka, - Malisheva, - Dragash, - Rahovec, dhe - Mamusha 	<p>Rajoni Ekonomik Qendror (zonat e <i>afërta</i>) përfshinë këto komuna:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Prishtinë, - Lipjan, - Fushe Kosovë, - Drenas, - Obiliq, - Podujevë - Gracanica

¹⁰ Aktivitetet e zbatuara jashtë zonës së programit mund të justifikohen vetëm në raste të jashtëzakonshme, kur projekti mund të dëshmojë se mund t'i arrijë objektivat e tij vetëm me zbatimin e këtyre aktivitetëve.

Llojet e veprimeve

Për të qenë i pranueshëm, një **veprim** i cili mund të financohet nga kjo Thirrje **duhet** të plotësojë kriteret në vazhdim:

- të japë një përfitim të qartë ndër- kufitar;
- përfshijë partnerë nga të dyja anët e kufirit (shih seksionin 2.1.4);
- të krijojë kontakte dhe lidhje në mes komuniteteve lokale në zonën e programimit;
- përkrah lidhjet ndërmjet institucioneve / organizatave relevante nga të dy anët e kufirit;
- të jetë në përputhje me legjislacionin kombëtar [të secilit vend përfitues] në lidhje me ndërtimet dhe punimet, legjislacionin për mjedisin kombëtar dhe mbrojtjen e natyrës, dhe me strategjitë kombëtare për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, të turizmit dhe zhvillim të bujqësisë;
- siguroj se të gjitha investimet (p.sh. punimet në infrastrukturë) të kryhet në përputhje me legjislacionin përkatës për mjedisin të Bashkimit Evropian. Procedurat për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM) siç janë përcaktuar në Udhëzimin VNM¹¹ të aplikohen plotësisht në të gjitha projektet e investimeve nën IPA. Nëse Udhëzimi VNM nuk është vendosur plotësisht, procedurat duhet të jenë të ngjashme me ato të përcaktuara në Udhëzimin e sipërpërmendur. Nëse një projekt ka të ngjarë të ndikojë në vendet me rëndësi për ruajtjen e natyrës, një vlerësim i saktë i ruajtjes së natyrës duhet të bëhet, ekuivalent me atë që parashikohet në nenin 6 të Udhëzimit Habitat¹²

Shënim: Shpenzimet për investim në pajisje / infrastrukturë **nuk mund të tejkalojnë:**

- Për furnizues: 50% të kostos totale të pranueshme;
- Për punime: 70% të kostos totale të pranueshme për punime; dhe
- Për punë dhe furnizime kumulative: 70% të kostos totale të pranueshme.

Veprimet duhet të ndërlidhen me objektivat e deklaruara në seksionin 1.2.

Llojet e veprimeve

Llojet indikative të aktiviteteve që mund të financohen sipas kësaj ftese për propozime janë dhënë më poshtë. Lista në vijim nuk është shteruese dhe aktivitetet e përshtatshme creative që nuk janë të përmendura më poshtë mund gjithashtu të konsiderohen për mbështetje. Me anë të ilustrimit projektet të përmbajnë një sërë të aktiviteteve në vijim:

Masa 1.1 : Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik, social dhe mjedisor

- Ndërhyrjet në shkallë të vogël për përmirësim të infrastrukturës ekzistuese që kanë ndikim konkret ndërkufitar, socio - ekonomik ose mjedisor, dhe / ose infrastrukturë ndërkufitare
- Projektet e infrastrukturës që lehtësojnë tregtinë dhe komunikimin brenda zonës së programimit.
- Operacionet që mbështesin turizmit rural: Infrastrukturë, trajnime, fushata të vogla informative, etj
- Operacionet për përmirësimin e përdorimit dhe mirëmbajtjen e zonave të kullotave
- Operacionet që mbështesin krijimin e një parku kombëtar në Malet e Sharrit në anën maqedonase dhe që përmirësojnë menaxhimin e Parkut Kombëtar në Kosovë
- Hulumtime të përbashkëta për prodhimin e energjisë së ripërtërishme dhe alternative në zonën e mbuluar nga programi
- Projektet që mbështesin mbrojtjen, brandingun dhe marketingun e produkteve tradicionale bujqësore dhe të zejtarisë.
- Operacionet që nxisin bashkëpunimin në mes të OSHC-ve dhe komunave në fushën e mbrojtjes së mjedisit; organizimi i ngjarjeve kulturore; mirëmbajtja dhe rehabilitimi i trashëgimisë historike; shënjimi i shtigjeve malore.

Masa 1.2: Kohezioni social dhe iniciativat njerëzit për njerëzit

¹¹ Direktiva e Këshillit 85/337/EEC i datës 27 qershor 1985 mbi vlerësimin e efekteve të projekteve përkatëse publike dhe private në mjedis (OJ L 175, 5.7.1985, p. 40. Direktiva së fundi e ndryshuar me Direktivën 2003/35/EC, OJ L 156, 25.6.2003, f. 1).

¹² Direktiva e Këshillit 92/43/EEC e 21 maj 1992 mbi mbrojtjen e habitateve natyrore dhe faunës dhe florës së egër (OJ L206, 22.7.1992). Direktiva së fundi e ndryshuar me Rregulloren (EC) Nr 1882/2003 (OJ L284, 31.10.2003, f. 1)

- Operacionet që mbështesin rrjetet e OSHC-ve rajonale, OSHC-të bazë në zona rurale (p.sh. partneritet në mes të OSHC-ve me përvojë / baze OSHC-ve; ngritja e kapaciteteve për OSHC-të , shkëmbim i përvojave dhe njohurive);
- Mbështetje për nxitjen e bashkëpunimit të OSHC-ve në përfshirjen sociale, kulturë, mbrojtjen e shëndetit dhe mjedisit.
- Përkrahje për promovimin e shëndetit në shkolla dhe ndërtimin e sistemeve të qëndrueshme të ndërgjegjësimit shëndetësor veçanërisht për njerëzit në nevojë dhe të marginalizuar.
- Bashkëpunimi ndër-komunal: bartja e përvojave në procesin e decentralizimit; shërbime për qytetarët;
- Operacionet që synojnë forcimin e të drejtave të minoriteteve;
- Bashkëpunimi dhe aktivitetet e përbashkëta të shoqatave rinore dhe sportive
- Operacionet e përbashkëta me synim të promovimit të shkëmbimit të arsimit dhe akademik në të gjitha nivelet;
- Mbështetje për veprimet e përbashkëta të reja që kanë për qëllim futjen e praktikave të reja turistike;
- Mbështetje për promovimin e produkteve rajonale nëpërmjet organizimit të ekspozitave ndërkufitare të biznesit,
- Mbështetje për veprimet e përbashkëta kreative që kanë për qëllim futjen e praktikave të reja të biznesit, veçanërisht në turizëm;
- Projekte hulumtuese dhe zhvillimore që përfshijnë universitetet dhe aktorët profesionale apo autoritete lokale dhe rajonale;
- Aktivitetet shkëmbimi për të rinjtë;
- Operacionet që synojnë rehabilitimin dhe promovimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë dhe traditave historike dhe kulturore, dhe që nxisin shkëmbime kulturore.

Llojet e veprimeve në vazhdim nuk janë të pranueshëm:

- veprimet që kanë të bëjnë vetëm apo kryesisht me sponsorizime individuale për pjesëmarrje në punëtori, seminare, konferenca, kongrese;
- veprimet që kanë të bëjnë vetëm apo kryesisht me bursa individuale për studime ose kurse trajnimi;
- blerje e tokës ;
- veprimet që kanë për qëllim përmirësimin e infrastrukturës dhe pajisjeve në objekte në pronësi private;
- veprimet që kanë për qëllim vendpushimet dhe zona turistike që tashmë janë të zhvilluara mirë, të reklamuar në mënyrë intensive dhe të njohura gjerësisht ;
- studime përgatitore ose për përgatitjen e projektimit paraprak për punët që do të kryhen në kuadër të projektit;
- veprimet pa ndikim ndërkufitar ;
- veprimet që ndërlidhen me aktivitetet fitimprurëse;
- veprimet e lidhura me partitë politike ;
- veprimet që bien në kuadër të aktiviteteve të përgjithshme të institucioneve kompetente shtetërore ose shërbime të administratës shtetërore, përfshirë edhe pushtetin lokal;
- veprimet që kërkojnë financim për aktivitete të zakonshme (rutinore) për aktivitetet e organizatave vendore, sidomos për të mbuluar shpenzimet e tyre operacionale;
- veprimet e filluara para nënshkrimit të kontratës;
- veprimet që mbulohen nga programe të tjera të Bashkimit Evropian;
- veprimet që kufizohen në donacione bamirëse ;
- veprimet që lidhen me:

o industrinë e duhanit (kodi CAEN 16);

o prodhimin e pijeve alkoolike të distiluara (kodi CAEN 1591);

o armëve dhe municioneve (kodi CAEN 296).

Përkrahje financiare për palët e treta: Nën-granti

Aplikantët mund të propozojnë mbështetje financiare për palë të treta (nën-grante), në mënyrë që të ndihmojnë në arritjen e objektivave të veprimit. Megjithatë, nën- granti nuk mund të jetë qëllimi kryesor i veprimit dhe ai duhet të justifikohet në mënyrë të duhur.

Vini re se në rast të nën-grantit, përgjegjësia financiare bie mbi koordinatorin që është respektivisht Aplikanti Kryesor.

Kur aplikanti parashikon dhënie të nën-grantit, ai/ajo duhet të specifikojë në aplikacionin e tij/saj shumën totale të grantit që do të përdoret për dhënien e nën-granteve, si dhe shumën minimale dhe maksimale për nën-grant. Një listë me llojet e aktiviteteve që mund të jenë të pranueshme për nën-grante duhet të përfshihen në aplikim, së bashku me kriteret që do të përdoren për përzgjedhjen e përfituesve të nën-granteve.

Shuma maksimale për një nën-grant individual është e kufizuar në EUR 10,000 për palën e tretë ndërsa shuma totale që mund t'u jepet si nën-grante palëve të treta do të jetë e kufizuar në 20% nga kostoja totale e veprimit

Në mënyrë më specifike, në përputhje me udhëzimet aktuale dhe sidomos me ndonjë kusht apo kufizim të përcaktuar më lartë, **aplikantët duhet të përcaktojnë detyrimisht në seksionin 2.1.1 të formularit të aplikimit për grant:**

- (i) objektivat dhe rezultatet që do të arrihen me përkrahjen financiare;
- (ii) llojet e ndryshme të aktiviteteve të pranueshme për përkrahje financiare në bazë të listës fikse;
- (iii) llojet e personave ose kategoritë e personave të cilët mund të marrin përkrahje financiare;
- (iv) kriteret për përzgjedhjen e këtyre subjekteve (shpallje publike) dhe dhënia e përkrahjes financiare;
- (v) kriteret për përcaktimin e shumës së saktë të përkrahjes financiare për secilin subjekt të tretë, dhe
- (vi) shuma maksimale që mund të jepet.

Vizibiliteti

Vini re se përfituesi/sit duhet të jenë në përputhje me objektivat dhe prioritetet, dhe të garantojë vizibilitet, të financimit të BE-së (shih Komunikatën dhe Doracakun e Vizibilitetit për veprime të jashtme të BE-së të përcaktuara dhe publikuara nga Komisioni Evropian në (shih http://ec.europa.eu/europeaid/qwork/visibility/index_en.htm).

Në veçanti:

Përfituesit e grantit duhet të sigurojnë se veprimet që janë tërësisht ose pjesërisht të financuara nga Bashkimi Evropian (BE) inkorporojnë informata dhe komunikojnë aktivitete të dizajnuara për të rritur ndërgjegjësimin e publikut specifik ose të përgjithshëm të arsyeve për veprim dhe mbështetjen e BE-së për veprim në vendin apo rajonin në fjalë, si dhe rezultatet dhe ndikimin e kësaj mbështetjeje. Të gjitha ngjarjet e vizibiliteti si dhe materialeve të prodhuara në kuadër të projektit të financuar nga BE duhet **të përfshijnë informacion të detyrueshëm që veprimet janë tërësisht ose pjesërisht të financuara nga Bashkimi Evropian (BE)**, si në vijim: logo e BE-së, titulli i projektit dhe fjalia: "Ky projekt është financuar nga Bashkimi Evropian".

Projekti duhet të ndajë buxhet të përshtatshëm për aktivitetet e komunikimit në mënyrë që të jetë i mjaftueshme për të pasur një ndikim të vërtetë, dhe të reflektojë madhësinë, dhe rrjedhimisht ndikimin e mundshëm të veprimit. Një plan i buxhetuar **i komunikimit dhe vizibilitetit** duhet të përfshihet në planin e punës së çdo veprimi të financuar nga BE ose të ndonjë veprimi të bashkë-financuar, duke theksuar aktivitetet e komunikimit të jashtëm që duhet të mbahen në faza kyçe në jetën e veprimit. Sidoqoftë, duhet të ketë hapësirë në çdo plan për të kapur një mundësi të mirë. Refleksi i mirë i komunikimit dhe aftësia për të shfrytëzuar mundësitë e papritura në dobi të veprimit, shpesh janë aq të rëndësishme sa edhe përpjekjet formale dhe shpesh mund të jenë të lira nga shpenzimet.

Organizimi i një ngjarje publike apo pjesëmarrja në një eveniment të organizuar, të pavarur nga veprimi, (për shembull, konferenca, punëtori, seminare, panairë, ekspozita, etj) mund të ofrojë mundësi të shkëlqyeshme për të gjeneruar interes në arritjet e veçanta të projektit, përveç materialeve promovuese të projektit të financuar nga BE. Ata që ndjekin kurse trajnimi të financuara nga BE, konferenca, seminare, panairë, ekspozita dhe punëtori duhet të jenë në dijeni se BE-ja po e financon ngjarjen, prandaj edhe mediet duhet të jenë të informuara gjithashtu.

Para inicimit të çfarëdo informate, komunikimi apo aktivitete të vizibilitetit, përfituesit dhe partnerët në zbatim duhet të konsultohet me delegacionin e BE-së/Zyrën e Bashkimit Evropian, me Zyrarët për Shtyp dhe Informim dhe Menaxherët e Detyrës të projekteve të financuara nga BE. Delegacioni i BE-së/ Zyra e Bashkimit Evropian duhet gjithmonë të ftohen për të marrë pjesë në ngjarje të vizibilitetit dhe komunikimit.

Numri i aplikimeve për grant për aplikantë

Aplikanti **nuk do të dorëzoj më shumë se një aplikacion** për këtë Thirrje për Propozime.

Aplikantit **nuk do t'i jepet më shumë se një grant** për këtë Thirrje për Propozime.

Aplikanti **nuk do të jetë bashkë-aplikantë apo subjekt i ndërlidhur** në ndonjë aplikim tjetër në të njëjtën kohë.

Bashkë-aplikanti **nuk do të dorëzoj më shumë se një aplikim** për këtë Thirrje për Propozime.

Bashkë-aplikantit **nuk do t'i jepet më shumë se një grant** për këtë Thirrje për Propozime.

Bashkë-aplikanti **nuk do të jetë aplikantë apo subjekt i ndërlidhur** në ndonjë aplikim tjetër në të njëjtën kohë.

Subjektet e ndërlidhura mnuk mund të marrin pjesë në më shumë se një aplikim.

2.1.6 Pranueshmëria e kostos: kostot që mund të përfshihen

Vetëm 'kostot e pranuar' mund të mbulohen nga granti. Kategoritë e kostos që janë të pranueshme dhe të pa pranueshme janë paraqitur më poshtë. Buxheti është edhe vlerësim i kostos dhe limiti për 'kostot e pranueshme'.

Kompensimi i kostos së pranueshme mund të bazohet në cilindo kombinim të formave në vazhdim:

- kostot aktuale të shkaktuara nga Përfituesi (sit) dhe subjekti (tet) e ndërlidhura
- një ose më shumë mundësi të thjeshtuara të kostos

Mundësitë e thjeshtuara të kostos mund të marrin formën e:

- **kostot për njësi:** mbulon të gjitha ose disa kategori specifike të kostos së pranueshme të cilat janë identifikuar në mënyrë të qartë paraprakisht duke ju referuar një sasi për njësi.
- **shumë totale:** që mbulon në aspektin global të gjitha ose disa kategori specifike të kostos së pranueshme të cilat janë identifikuar në mënyrë të qartë paraprakisht.
- **financimi me tarifë fikse:** që mbulon kategoritë specifike të kostos së pranueshme të cilat janë identifikuar në mënyrë të qartë paraprakisht duke aplikuar një përqindje të caktuar ex ante.

Shumat ose normat duhet të bazohen në vlerësime të përafërta duke përdorur të dhëna objektive siç mund të jenë të dhënat statistikore ose çdo mjet tjetër objektiv që i referohet të dhënave të certifikuar ose të audituar historike të aplikantëve apo të subjekteve të ndërlidhura. Metodatat e përdorura për të përcaktuar shumatat ose normat e kostos për njësi, shumës totale ose tarifës fikse duhet të jenë në përputhje me kriteret e vendosura në Aneksin K, dhe në veçanti të sigurojnë që shpenzimet korrespondojnë në mënyrë të drejtë me kostot aktuale të shkaktuara nga Përfituesi (sve) e Grantit dhe Subjektit (eve) të ndërlidhura, janë në përputhje me praktikatat e tyre të kontabilitetit, që asnjë përfitim nuk është bërë dhe që shpenzimet mbulohen tashmë nga burime të tjera të financimit (jo financim i dyfishtë). Referojuni Aneksit K për udhëzime dhe një listë të kontrollit për të vlerësuar kushtet minimale të nevojshme që ofrojnë siguri të arsyeshme për pranimin e shumave të propozuara.

Aplikanti që propozon këtë formë të kompensimit, duhet të tregojë në mënyrë të qartë në fletën punuese nr.1 të Aneksit B, çdo titull/ njësi të kostos të pranueshme që ndërlidhet me këtë lloj të financimit, gjegjësisht të shtoj referencën në shkronja të mëdha " KOSTO E NJESISE" (në muaj / fluturim etj), " SHUMA TOTALE" ose "TARIFA FIKSE " në kolonën e Njesisë. (shih shembullin në Aneksin K)

Përveç kësaj në Aneksin B, në kolonën e dytë të fletës punuese nr.2, "Arsyetimi i kostos së vlerësuar " për secilën nga pikat korresponduese të buxhetit apo titullit aplikanti duhet të:

- përshkruajnë të dhënat dhe metodatat e përdorura për të vendosur shumën e kostos për njësi, shumën totale dhe / ose tarifën fikse cilëndo kosto që i referohet, etj

- shpjegojë qartë formulat për llogaritjen e shumës së pranueshme përfundimtare¹³

- të identifikojë përfituesin që do të përdori mundësinë e thjeshtuar të kostos (në rast të subjektit të ndërlidhur, të specifikojë së pari përfituesin), me qëllim që të verifikojë shumën maksimale për çdo përfitues (e cila përfshin nëse është e zbatueshme mundësia e thjeshtuar të kostos apo subjekti (et) e ndërlidhura).

Në fazën e kontraktimit, Autoriteti Kontraktues vendos nëse do të pranojë shumat e propozuara ose normat në bazë të buxhetit të përkohshëm të dorëzuar nga aplikanti, duke analizuar të dhënat faktike të granteve të kryera nga aplikanti ose nga veprime të ngjashme dhe duke kryer kontrolle të përcaktuara në Aneksin K.

Shuma e përgjithshme e financimit, në bazë të mundësive të thjeshtuara të kostos, që mund të jetë autorizuar nga Autoriteti Kontraktues për ndonjë nga aplikantët individual (duke përfshirë mundësitë e thjeshtuara të kostos së propozuar nga subjektet e tyre të ndërlidhura) nuk mund të tejkalojë 60 000 Euro (kostot indirekte nuk janë marrë në konsideratë).

Për qëllim të kësaj Thirrjeje, Autoriteti Kontraktues autorizon përdorimin e **mundësisë së thjeshtuar të kostos vetëm** për nënvijat vijuese të buxhetit: **1.1. dhe 1.2. Pagat; 1.3 Mëditjet, 2.2 . Transporti lokal dhe 4.0 Zyra Lokale.**

Për më tepër, **shuma maksimale** që do të përdoret në bazë të mundësive të thjeshtuara të kostos sipas të gjitha njësive buxhetore të listuara më sipër është e kufizuar në 30% të shumës së përgjithshme të buxhetit për veprimin e propozuar. Ju lutem vini re se të gjitha shpenzimet e përfshira në mundësitë e thjeshtuara të kostos nuk duhet të tejkalojnë koston standarde të tregut të vendit (të punës, furnizimeve të vogla, shërbimet, etj).

Rekomandimet për dhënien e një granti i nënshtrohen gjithmonë kushtit që kontrollimi që i paraprinë nënshkrimit të kontratës nuk do të zbulojë problemet që kërkojnë ndryshime në buxhet (të tilla si gabime aritmetike, pasaktësi, shpenzimet jorealiste dhe shpenzime të papranueshme). Kontrollat mund të rrisin kërkesat për sqarim dhe mund të bëjnë që Autoriteti Kontraktues të imponoj modifikime ose reduktime për të adresuar gabime ose pasaktësi të tilla. Nuk është e mundur që të rritet granti apo përqindja e bashkë-financimit të BE-së, si rezultat i këtyre korigjimeve.

Prandaj, është në interesin e aplikantit që të ofroj një buxhet **realist dhe me kosto efektive**.

Kostot Direkte të Pranueshme

Për të qenë të kualifikueshëm për Thirrje për Propozime, kostoja duhet të jetë në përputhje me dispozitat e nenit 14 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës Standarde të Grantit (shih Shtojcën G të Udhëzimeve. Në veçanti:

Kostot e pranueshme janë kostot që aktualisht janë shkaktuar nga përfituesi i këtij granti të cilat i plotësojnë të gjitha kriteret e mëposhtme:

- ato janë shkaktuar gjatë zbatimit të veprimeve, siç është përcaktuar në Nenin 2 të Kushteve të Veçanta (shih shtojcën D të këtyre Udhëzimeve) me përjashtim të shpenzimeve që lidhen me raportet përfundimtare, verifikimin dhe vlerësimin e shpenzimeve të veprimit, pavarësisht kohës aktuale të kompensimit nga Përfituesi (it). Procedurat për dhënien e nën-kontratave për mallra / shërbime / punë të kryera / të parashikuara / dorëzuara gjatë periudhës së zbatimit, siç përmendet në nenin 1.3 paragrafi 3 të Kushteve të Përgjithshme (shih edhe shtojcën D), mund të kenë filluar, por kontrata nuk mund të konkludohet nga Përfituesi (it) para fillimit të periudhës së zbatimit të Veprimit, me kusht që dispozitat e Aneksit IV (shih gjithashtu Shtojcën D) janë respektuar,
- duhet të tregohen në buxhetin e përgjithshëm të parashikuar të veprimit ,
- duhet të jenë të nevojshme për zbatimin e veprimit që është objekt i grantit,
- janë të identifikueshme dhe të verifikueshme, veçanërisht duke u regjistruar në regjistrat e kontabilitetit të përfituesit (ve) dhe përcaktohen në përputhje me standardet e kontabilitetit të vendit ku përfituesi (it) është

¹³ Shembuj:-për shpenzimet e stafit: numri i orëve apo ditëve të punës * norma për orë ose për ditë e paracaktuar sipas kategorisë së personelit përkatës;- për shpenzimet e udhëtimit: distanca më km *shpenzime e paracaktuara të transportit për km; numri i ditëve * mëditja ditore e paracaktuar sipas shtetit;- për shpenzime specifike që shkaktohen nga organizimi i një ngjarjeje: numri i pjesëmarrësve në ngjarje* shpenzimet totale të paracaktuara për pjesëmarrës etj.

vendosur dhe sipas praktikave të zakonshme të kontabilitetit të kostos së përfituesit

• duhet të jenë të arsyeshme, të justifikuar dhe në përputhje me kërkesat e menaxhimit të shëndoshë financiar, në veçanti në lidhje me ekonominë dhe efikasitetin.

Duke iu nënshtruar kritereve të mësipërme, dhe ku aplikohet, dispozitave të Aneksit IV të Kontratës Standarde të Grantit (shi Aneksin D), kostoja direkte në vijim e Përfituesit (sve) do të jetë e pranueshme:

- Kostoja e personelit të caktuar për veprimin, që korrespondon me pagat aktuale bruto plus pagesat e sigurimeve shoqërore dhe shpenzime të tjera të lidhura me shpërblimet, **pagat dhe shpenzimet nuk duhet të tejkalojnë ato që normalisht mbulohe nga Përfituesi (it)**, siç mund të jetë rasti, vetëm nëse është e justifikuar duke treguar se ajo është e domosdoshme për të kryer veprimin;
- Kostoja e udhëtimit dhe e jetesës për personelin dhe personat tjerë që marrin pjesë në veprim, me kusht që të mos i tejkalojnë ato që mbulohe zakonisht nga Përfituesi (sit), siç mund të jetë rasti. Çdo riimbursim i tarifës fikse të kostos për jetesë nuk duhet të tejkalojë normat e përcaktuara në Shtojcën G të këtyre Udhëzimeve, të cilat korrespondojnë me masat e publikuara nga Bashkimi Evropian në kohën e nënshkrimit të kontratës;
- Kostoja e blerjes dhe marrjes me qira të furnizimeve dhe pajisjeve në mënyrë specifike për qëllime të, dhe e kufizuar në minimumin e nevojshëm për zbatimin e Veprimit, dhe kostoja e shërbimeve, me kusht që të korrespondojnë me normat e tregut;
- Kostoja e konsumit;
- Shpenzimet ose kostot e nën-kontraktimi që burojnë nga organizimi i seminareve, punëtorive, konferencave, panairëve apo çdo ngjarje tjetër publike;
- Shpenzimet që dalin direkt nga kërkesat e kontratës (shpërndarja e informatave, vlerësimit specifik i veprimit, auditimet, përkthimet, shtypi, sigurimit, etj);
- Vlera e shtuar e taksave, nëse janë plotësuar kushtet e mëposhtme:
 - o ata nuk janë të kthyeshme me asnjë mjet;
 - o kur konstatohet se ato mbulohe nga përfituesi përfundimtar; dhe
 - o ato janë të identifikuar qartë në projekt propozim.
- pagesat për transaksionet financiare transnacionale;
- kur zbatimi i një operacioni kërkon një llogari të veçantë ose të hapen llogari, tarifatat bankare për hapjen dhe administrimin e llogarive;
- tarifatat ligjore e konsulencës, taksat noteriale, kostot për ekspertë teknikë ose financiarë, dhe kostot e kontabilitetit ose auditimit, nëse ato janë të lidhura direkt me një operacion të bashkë-financuar dhe janë të nevojshme për përgatitjen ose zbatimin e tij;
- kostoja e garancive të siguruara nga një bankë ose institucione të tjera financiare, deri në masën që garancitë kërkohen nga legjislacioni vendor ose i Bashkimit Evropian;
- kostoja e zyrës lokale (në rastin e qirasë në veçanti për nevojën e projektit);
- kostoja për punë dhe mbikëqyrjen e hapësirës gjatë zbatimit të kontratës përkatëse të punëve.

Kostoja e vizibilitetit: pasi që përfituesit e grantit duhet të respektojnë obligimin e vizibilitetit dhe pasi që vizibiliteti mund të jetë instrumental në suksesin e një veprimi Autoriteti Kontraktues fuqimisht rekomandon që përfituesit të parashohin minimum 1 % të kostos totale të pranueshme për koston e vizibilitetit. Kjo natyrisht mund të ndryshojë varësisht nga natyra e veprimit.

Fondi emergjent rezervë

Buxheti mund të përfshijë një fond emergjent rezervë (për shpenzimet e paparashikuara) që nuk tejkalon 5% të kostos së pranueshme direkte. Një fond emergjent rezervë është shpesh shumë i dobishëm dhe inkurajohet fuqimisht. Ai mund të përdoret vetëm **me autorizim paraprak** me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.

Kostot e pranueshme indirekte

Kostot indirekte janë shpenzimet të cilat, duke pasur parasysh kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara më sipër, nuk janë të identifikueshme si kosto specifike të lidhura drejtpërdrejt me kryerjen e veprimit që mund të rezervohen për atë direkt, por që mund të identifikohen dhe justifikohen nga përfituesi duke përdorur sistemin e tij të kontabilitetit si të shkaktuara në lidhje me koston e pranueshme direkte të veprimit. Ato nuk mund të përfshijnë ndonjë kosto direkte të pranueshme. Kostot e tilla janë zakonisht kostot strukturore dhe mbështetëse të natyrës administrative, teknike dhe logjistike të cilat janë ndërsektoriale për funksionimin e aktiviteteve të ndryshme të organit përfitues dhe për këtë arsye nuk mund të rezervohen në mënyrë të plotë për veprimin për të cilin është dhënë granti, sepse ky grant është vetëm një pjesë e këtyre aktiviteteve (p.sh. punësimin ose amortizimin e ndërtesave dhe bimëve, shpenzimet e ujit / gazit / energjisë elektrike, mirëmbajtjes, sigurimit, furnizime dhe pajisje të vogla për zyre, kostoja e komunikimit dhe lidhjes, posta etj.) dhe kostot e lidhura me shërbime horizontale si menaxhimi administrativ dhe financiar, burimet njerëzore, trajnim, këshillim ligjor, dokumentacioni, IT, etj.

Kostot indirekte të bëra për kryerjen e veprimit **mund të jenë të pranueshme për financim të tarifës fikse, por totali nuk mund të tejkalojë 7% të totalit** të kostove të pranueshme direkte. Kostot indirekte janë të pranueshme me kusht që ato nuk përfshijnë kostot e caktuara në ndonjë vijë tjetër buxhetore në kontratën standard të grantit. Aplikantit mund ti kërkohet të justifikoj përqindjen e kërkuar para nënshkrimit të kontratës. Megjithatë, pasi që të caktohet tarifa fikse në kushtet e veçanta të kontratës standarde të grantit, nuk ka nevojë të dorëzohen dokumente mbështetëse. Nëse ndonjë nga aplikantët apo subjektet e ndërlidhura është në pranim të një granti operativ të financuar nga BE, nuk mund të pretendoj koston indirekte në koston e shkaktuar përbrenda buxhetit të propozuar për veprim.

Kontributet në mallëra

Kontributi në mallra do të thotë ofrimi i mallrave dhe shërbimeve për Përfituesin (sit) apo subjektin (tet) e ndërlidhura pa pagesë nga palët e treta. Pasi që kontributet në mallra nuk përfshijnë ndonjë shpenzim për Përfituesin (sit) apo për subjektin (tet) e ndërlidhura, **ato nuk janë kosto e pranueshme.**

Kontributet në mallra **mund të mos** trajtohen si bashkëfinancim. Sidoqoftë, nëse përshkrimi i veprimit siç është propozuar përfshinë kontributet në mallra, kontributet duhet të bëhen.

Kostot e papranueshme

Kostot në vijim janë të papranueshme:

- borxhi dhe tarifa për shërbim të borxhit;
- interesi;
- taksat, përfshirë taksat e vlerës së shtuar dhe taksa e të ardhurave personale. Taksat e vlerës së shtuar mund të konsiderohen si kosto e pranueshme vetëm nëse kushtet në vijim janë plotësuar:
 - i. ato nuk janë të kthyeshme me çfarëdo mjeti dhe përfituesi është në gjendje të dëshmoj
 - ii. është vendosur se ato do të barten nga përfituesi
 - iii. janë të identifikuar qartë në projekt propozimin
- dispozitat për humbje apo detyrime potenciale të ardhshme;
- taksa doganore dhe e importit të mallrave, apo çfarëdo takse tjetër;
- gjobat, ndëshkimet financiare dhe shpenzimet e ndërgjyqësore;
- kostoja operative;
- pajisjet e dorës së dytë;
- tarifat bankare, kosto e garancionit dhe tarifa të ngjashme përveç për
 - i. tarifa bankare për hapje dhe administrim të llogarisë, kur zbatimi i një funksioni kërkon një llogari të veçantë apo të hapen llogari;
 - ii. kostoja e garancionin që ofrohet nga banka apo nga ndonjë institucion tjetër financiar deri në atë masë që garancioni kërkohet nga legjislacioni vendor apo i komunitetit;
- kosto e deklaruar nga Përfituesi (it) dhe e financuar nga një tjetër veprim ose program pune që merr grant të Bashkimit (përfshirë përmes EDF);
- kostot e shkëmbimeve , tarifat dhe humbjet e shkëmbimit që ndërlidhen më ndonjë nga llogaritë specifike në euro të veprimit, si dhe shpenzimet tjera financiare;

- kontributet në mallra;
- çfarëdo leasing dhe kostot e amortizimit;
- interesi në borxh;
- blerjet e tokës ose ndërtesës, përveç kur është e nevojshme për zbatim direkt të veprimit, në të cilin rast pronësia duhet të transferohet tek përfituesit përfundimtar dhe/ose Përfituesi (it) lokal më së largu deri në fund të veprimit;
- humbjet e këmbimit të monedhës;
- kreditë për palët e treta përveç nëse specifikohet ndryshe në Kushtet e Veçanta.

Ju lutem vëni re:

Grantet nuk mund të kenë për qëllim ose të ndikojnë për të prodhuar fitim për përfituesin si rezultat direkt i operacioneve / aktiviteteve të financuara nga granti.

Prandaj, shërbyesit civil ose punonjës tjerë publik të administratës qendrore dhe lokale të cilët marrin pjesë në këtë ftesë për propozime nuk janë të pranueshëm për financim të BE-së dhe nuk mund të marrin pagesa për kontributin e tyre në veprim, përveç pagave të tyre në institucionin përkatës. Pagat e nëpunësve eventual civil apo të punonjësve tjerë publik të administratës qendrore dhe lokale mund të paraqitet si bashkë-financim i kontributit të aplikantit deri në përqindjen e bashkëfinancimit të nevojshme për veprim.

2.2 SI TË APLIKONI DHE PROCEDURAT QË DUHET NDJEKUR

Regjistrim paraprak në PADOR për këtë Thirrje për Propozime NUK është i obligueshëm, por inkurajohet.

PADOR është një bazë e të dhënave në të cilën organizatat regjistrohen dhe azhurnojnë të dhënat e tyre në baza të rregullta përmes

Ueb faqes EuropeAid: http://ec.europa.eu/europeaid/ëork/onlineservices/pador/index_en.htm

Të gjitha pyetjet që kanë të bëjnë me regjistrimin në PADOR duhet të adresohen në zyrën ndihmëse në: [Europeaid- pador@ec.europa.eu](mailto:Europeaid-pador@ec.europa.eu).

2.2.1 Forma e Aplikacionit

Aplikacionet duhet të dorëzohen në përputhje me udhëzimet në Dokumentin e Konceptit dhe Formularin e plotë të Aplikacionit në Formularin e Aplikimit për Grant në anekse të këtyre Udhëzimeve (Aneksi A)

Aplikantët duhet të aplikojnë në gjuhën Angleze.

Çdo gabim apo mospërputhje e madhe në lidhje me pikat e listuara në udhëzimet e Dokumentit të Konceptit ose ndonjë mospërputhje e madhe në formularin e aplikimit (p.sh. nëse shumat në fletën e punës buxhetore janë në kundërshtim) mund të çojë në refuzimin e aplikimit.

Sqarime do të kërkohen vetëm kur informacioni i dhënë është i paqartë dhe në këtë mënyrë e parandalon Autoriteti Kontraktues të kryej një vlerësim objektiv. Aplikacionet e plotësuara me dorë nuk do të pranohen. Ju lutem vini re se vetëm forma e aplikimit dhe anekset e publikuara të cilat duhet të plotësohen (buxheti, korniza logjike) do të vlerësohen. Prandaj është e një rëndësie të madhe që këto dokumente të përmbajnë të gjitha informatat relevante në lidhje me veprimin. **Nuk duhet të dërgohen anekse shtesë.**

Dokumentet në vijim janë ato që duhet të dorëzohen së pari si aplikim për Grant

ANEKSI A: FORMA E APLIKACIONIT PËR GRANT (NË ËORD)

ANEKSI B: BUXHETI (NË EXCEL)

ANEKSI C: KORNIZA LOGJIKE (NË ËORD)

Forma e aplikacionit është në dispozicion:

- në ueb faqen e Ministrisë së Vet-Qeverisjes Lokale në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë (<http://mls.gov.mk>);
- në uebfaqen e Ministrisë së Pushtetit Lokal dhe Administratës në Kosovë (<http://mapl.rks-gov.net>);
- në uebfaqen e (http://ec.europa.eu/europeaid/ëork/funding/index_en.htm)

Aplikantët duhet të verifikojnë se forma e aplikimit është complete bazuar në listën kontrolluese të bashkëngjitur në aplikacion (seksioni V) dhe se nënshkrimet dhe vulat zyrtare, kur kërkohet, të jenë të dukshme dhe të njohura në të versionet në origjinal dhe në kopje. Aplikacionet e pakompletuara mund të refuzohen.

Çdo Aplikant duhet të nënshkruaj Deklaratën nga Aplikuesi (seksionet 8a 8b të pjesës B të Formularit të Aplikimit për Grant). Deklarata duhet të jetë e shkruar me dorë e nënshkruar nga përfaqësuesi i autorizuar ligjor.

Të dy Aplikantët duhet të nënshkruajnë Marrëveshjen e Partneritetit në mes Aplikantëve (Neni 8c pjesa B e Formularit të Aplikimit për Grant). Deklarata duhet të jetë i shkruar me dorë e nënshkruar nga përfaqësuesi i autorizuar ligjor.

Mandati i bashkë-aplikantëve duhet të jetë i shkruar me dorë i nënshkruar nga të gjithë përfaqësuesit e autorizuar ligjor. (Neni 4.2 i Pjesës B të Formularit të Aplikimit për Grant)

Ju lutem sigurohuni që të gjitha dokumentet e mësipërme janë të nënshkruara nga përfaqësuesi ligjor i autorizuar i institucionit apo organizatës përkatëse.

Pavarësisht faktit se vetëm një formular i aplikimit dorëzohet, në përshkrim të veprimit duhet të qartësohet se cilat aktivitete janë zbatuar në secilën anë të kufirit, nga secili aplikant (apo partner) si dhe kontributi i secilit aplikant në secilin rezultat dhe/ose përfundim të pritur.

2.2.2. Ku dhe si të dërgoni Aplikacionet

Aplikacionet duhet të dorëzohen **në një (1) original dhe ty (2) kopje të madhësisë A4, secila e lidhur.** Forma complete e aplikacionit (Pjesa A: dokumenti i konceptit dhe Pjesa B: komplet forma e aplikacionit), buxheti dhe korniza logjike duhet të dorëzohet në formën elektronike (CD-Rom) në një dosje të veçantë (dmth formulari i aplikimit nuk duhet të ndahet në disa dosje të veçanta) – në një format që i lejon modifikimet për qëllime të kontratës. Formatit elektronik duhet të përmbaj **saktësisht të njëjtin** aplikacion sikurse versioni i dorëzuar i shtypur.

Lista Kontrolluese (Seksioni 7 i Pjesës B të formularit të aplikimit për grant) dhe deklaratën nga aplikanti (Seksioni 8 i Pjesës B i formularit të aplikimit për grant) duhet të jenë të kapura veçanërisht dhe të mbyllura në zarf.

Zarf ii jashtëm duhet të ketë **numrin e referencës dhe titullin e Thirrjes për Propozime**, së bashku me [titullin dhe numrin e masës,] emrin e plotë dhe adresën e apliknatit dhe bashkë-aplikantit/partnerit udhëheqës, dhe fjalët **‘Not to be opened before the opening session’** / “ **Да не се отвара пред сесијата за отварање**”/“**Të mos hapet përpara sesionit të hapjes së aplikimeve**””.

Aplikimet duhet të dorëzohen në zarfe të mbyllur me postë të regjistruar, shërbime private të dërgesës ose të dorëzohen me dorë (një certifikatë e nënshkruar me datën e pranimit duhet t’i jepet dorëzuesit) në adresën në vijim:

Adresa postale dhe adresa për dorëzim me dorë apo përmes shërbimeve të dërgesës private

Joint Technical Secretariat (JTS)-Kumanovo
Hristijan Todorovski Karpos 73,
1300 Kumanovo , the former Yugoslav Republic of Macedonia

Aplikacionet e dërguara në mënyrë tjetër (p.sh. me anë të faksit apo postës elektronike) ose të dërguara në adresë tjetër do të refuzohen.

Aplikantët duhet të verifikojnë se aplikacioni i tyre është kompletuar duke përdorur listën kontrolluese (Seksioni 7 i Pjesës B të formularin të aplikimit për grant). Aplikacionet e pakompletuara mund të refuzohen

2.2.3 Afati i fundit për dorëzim të aplikacioneve

Afati i fundit për dorëzim të aplikacioneve është 20 janar 2014 siç dëshmohet nga data e dërgimit, vulën postare ose nga data e dëshmisë së depozitës. Në rast të dërgimit me dorë, afati i fundit për pranimit është ora **16:00 lokale** siç dëshmohet nga fleta e nënshkruar dhe e datuar e pranimit. Çdo aplikacion i dorëzuar pas afatit të fundit do të refuzohet me automatizëm.

Sidoqoftë, për arsye të efikasitetit administrative, Autoriteti Kontraktues mund të refuzoj cilindo aplikacion të dorëzuar me kohë por të pranuar pas datës efektive të miratimit të hapit të parë vlerësues (dmth Dokumentin e Konceptit) (shih kalendarin indikativ nën Seksionin 2.5.2)

2.2. Informata të mëtutjeshme lidhur me Aplikacione

Data, koha dhe vend ii sesioneve informative në këtë thirrje për propozime do të publikohet Brenda 15 ditësh që ng shpallja e kësaj thirrje për propozime në ueb faqet e Ministrisë së Vetqeverisjes Lokale të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë: www.mls.gov.mk, [Ministria e Qeverisjes Lokale dhe e Administratës në Kosovë](#): <http://mapl.rks-gov.net> dhe e EuropeAid (http://ec.europa.eu/europeaid/ëork/funding/index_en.htm)

Pyetjet mund të dërgohen me anë të postës elektronike ose me faks jo më vonë se 21 ditë para afatit të fundit për dorëzim të aplikacioneve në adresën më poshtë, duke treguar qartë referencën e thirrjes për propozime:

E-mail adresa: jts.mackos@gmail.com, martina.antic@mls.gov.mk; (ju lutem shtoni së paku edhe një adresë në cc për çdo rast;)

Fax: +389 31 488 717

Sekretariati i Përbashkët Teknik nuk ka obligim të ofroj sqarime shtesë pas kësaj date. Përgjigjet do të jepen jo më vonë se 11 ditë para afatit të fundit për dorëzim të aplikacioneve.

Për të siguruar trajtim të barabartë të aplikantëve, Sekretariati i Përbashkët Teknik nuk mund të japër mendim paraprak mbi pranueshmërinë e aplikantëve, subjekteve të ndërlidhura, veprimit apo aktiviteteve specifike.

Pyetjet që mund të jenë relevante për aplikantët tjerë, së bashku me përgjigjet si dhe shënimet tjera të rëndësishme për alikantët gjatë procesit të procedurës së vlerësimit do të publikohen në uebfaqen e Ministrisë së Vetqeverisjes Lokale të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë: www.mls.gov.mk, [Ministria e Qeverisjes Lokale dhe e Administratës në Kosovë](#): <http://mapl.rks-gov.net> dhe e EuropeAid <https://webgate.ec.europa.eu/europeaid/online-services/index.cfm?do=publi.ëlcome>

Prandaj është e këshillueshme që të konsultohen uebfaqet e sipërpërmendura rregullisht që të informoheni lidhur me pyetjet dhe përgjigjet e publikuara.

2.3 VLERËSIMI DHE PËRZGJEDHJA E APLIKACIONEVE

Vlerësimi dhe përzgjedhja e aplikacioneve sipas Programit është përgjegjësi e Komisionit të Përbashkët të Monitorimit (JMC), i përbërë nga përfaqësues të vendeve pjesëmarrëse. Komisioni i Përbashkët i Monitorimit (KPM) mund t'ia delegojë këtë detyrë një Komisioni të Përbashkët Drejtues (KPD) me ndihmën e mundshëm të vlerësuesve të jashtëm. Me kërkesë të KPM dhe pas miratimit paraprak të delegacioneve të BE-së, mund të jetë e mundur që të kombinohen fazat e procesit të vlerësimit dhe miratimi i tyre ex-ante.

Të gjitha veprimet e paraqitura nga aplikantët do të vlerësohen sipas hapave dhe kritereve të mëposhtme.

Nëse ekzaminimi i aplikimit zbulon se veprimi i propozuar nuk i plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në paragrafin 2.1, aplikimi do të refuzohet vetëm në këtë bazë.

(1) HAPI 1: HAPJA DHE KONTROLLI ADMINISTRATIV DHE VLERËSIMI I DOKUMENTIT TË KONCEPTIT

Do të vlerësohen në vijim:

- Përputhje me afatin e fundit të dorëzimit. Nëse afati i fundit nuk është respektuar, aplimi do të refuzohet me automatizëm.
- Formulari i Aplikacionit i plotëson kriteret e specifikuar në pikat 1-5 të Listës Kontrolluese (Seksioni 7 i Pjesës B të formularit të aplikimit për grant). Nëse ndonjë nga informatat e kërkuara mungon ose është e pasaktë, aplikimi mund të refuzohet **vetëm** në këtë bazë dhe aplikacioni nuk do të vlerësohet më tutje.

Dokumenti i Konceptit i cili e kalon kontrollin e parë administrative do të vlerësohet mbi relevancën dhe hartimin e veprimit të propozuar.

Dokumenti i Konceptit do të pranojë një vlerësim prej 50 duke përdorur ndarjen e tabelës vlerësuese. Vlerësimi gjithashtu do të kontrolloj pajtueshmërinë me udhëzimet në Dokumentin e Konceptit i cili mund të gjendet në Pjesën A të formularit të aplikacionit.

Kriteret vlerësuese janë të ndara në tituj dhe nëntituj. Çdo nëntitull do të vlerësohet nga 1 deri në 5 si në vijim: 1 = shumë dobët; 2 = dobët; 3 = adekuate; 4 = mirë; 5 = shumë mirë.

Rezultatet

1. Relevanca e veprimit	Nën-rezultati	30
1.1 Sa është relevant propozimi për objektivat dhe prioritetet e Thirrjes për Propozime?*	5x2*	
1.2 Sa është relevant propozimi për nevojat dhe kufizimet përkatëse të vendit (ve) apo rajonit (ve) të synuara (përfshirë ndërveprimin me iniciativa tjera të BE-së dhe në shmangien e duplikimit)?	5x2	
1.3 Sa janë qartë të definuar dhe strategjikisht të zgjedhur ata që janë të involvuar (përfituesit përfundimtarë, grupet e synuara)? A janë definuar qartë nevojat e tyre dhe a janë ato të adresuara në propozim sic duhet?	5	
1.4 A përmban propozimi elemente specifike të vlerës së shtuar, siç janë çështjet mjedisore, promovimi i barazisë gjinore dhe mundësi të barabarta, nevojat e njerëzve me nevoja të veçanta, të drejtat e minoriteteve dhe të drejtat e njerëzve vendas, qëndrueshmëri e mjedisit, ose inovacion dhe praktikat më të mira, qasje pjesëmarrëse me komunitetin e biznesit dhe aktorët e politikës?	5	
2. Hartimi i veprimit	Nën-rezultati	20
2.1 Sa është Koherent hartimi i përgjithshëm i veprimit? Në veçanti, a e reflekton analizën e problemit të involvuar, a i merr parasysh faktorët e jashtëm dhe palët relevante të interesit?	5x2*	
2.2 A është veprimi i realizueshëm dhe i qëndrueshëm lidhur me objektivat dhe rezultatet e pritura?	5x2*	

REZULTATI TOTAL 50

*këto rezultate shumëzohen me 2 për shkak të rëndësisë së tyre

Pasi që të vlerësohen të gjitha Dokumentet e Konceptit, do të hartohet një listë me veprimet e propozuara të radhitura në një listë të përgjithshme sipas rezultatit të tyre total.

Së pari, vetëm Dokumentet e Konceptit me rezultat prej së paku 30 pikëve do të konsiderohen për para-zgjedhje.

Së dyti, numri i Dokumenteve të Konceptit do të reduktohet, duke marr parasysh radhitjen ndaj numrit të Dokumenteve të Konceptit e të cilëve shuma agregate e kontributeve të kërkuara është e barabartë me **200%** të buxhetit në dispozicion për këtë Thirrje të Propozimeve. Shuma e kërkuar e kontributeve për secilin dokument të konceptit do të bazohet në zarfën indikativ financiar për secilën pjesë.

Pas vlerësimit të Dokumenteve të Konceptit, Komisioni i Përbashkët Drejtues (KPD) do tu dërgojë letra të gjithë aplikantëve, duke treguar nëse aplikimi i tyre është bërë brenda afatit kohor, duke i informuar lidhur me numrin e referencës që i është ndarë, dhe nëse është vlerësuar Dokumenti i Konceptit dhe rezultatit e atij vlerësimi.

KPM pastaj do të vazhdojë me aplikantët propozimet e të cilëve janë para-zgjedhur.

(2) HAPI 2: VLERËSIMI I TËRË APLIKACIONIT

Së pari do të vlerësohen në vijim:

- Forma e aplikimit të plotë i plotëson të gjitha kriteret e specifikuar në pikat 1-9 të Listës Kontrolluese (Seksioni 7 Pjesa B e formës së aplikimit për grant). Nëse ndonjë nga informatat e kërkuara mungon ose është e pasaktë, aplikimi mund të refuzohet **vetëm** në atë bazë dhe aplikimi nuk do të vlerësohet më tutje.

Kualiteti i aplikimeve, përfshirë buxhetin e propozuar dhe kapacitetin e aplikantëve dhe subjekteve të ndërlidhura, do të vlerësohet duke përdorur kriteret e vlerësimit në tabelën vlerësuese më poshtë. Janë dy lloje të kriterëve vlerësuese: përzgjedhja dhe kriteret për dhënie të grantit.

Kriteret e përzgjedhjes ndihmojnë të vlerësohet kapaciteti operativ i aplikantit dhe i subjekteve të ndërlidhura, kapaciteti financiar i aplikantit dhe gjithashtu të sigurohet që ata:

- Të kenë burime të qëndrueshme dhe të mjaftueshme financiare për të ruajtur veprimtarin e tyre përgjatë veprimit të propozuar dhe kur është e pranueshme të marrin pjese edhe në financimin e tyre.
- Të kenë kapacitetin menaxhues, kompetencat profesionale dhe kualifikimet e kërkuara për të kompletuar veprimin e propozuar me sukses. E njëjta aplikohet edhe për subjektet e ndërlidhura të aplikantëve.

Kriteri i shpërblimit ndihmon të vlerësohet cilësia e aplikantit në lidhshmëri me objektivat dhe prioritetet dhe për të dhënë grante si shpërblime për projektet të cilat e kanë maksimizuar efektivitetin e përgjithshëm të Thirrjes për Propozime. Ata ndihmojnë në përzgjedhjen e aplikacioneve për të cilat Autoriteti Kontraktues ka besim se do të jenë në përputhje me objektivat dhe prioritetet e tyre. Ato mbulojnë rëndësinë e veprimit, konsistencën e saj me objektivat e Thirrjes për propozime, cilësinë, ndikimin e pritur, qëndrueshmërinë dhe efektivitetin e kostos.

Rezultati:

Tabela e vlerësimit ndahet në seksione dhe nën seksione. Çdo nënseksion i seksionit 1 në tabelën e vlerësimit do të vlerësohet në atë se a është përmbushur kriteri apo jo. Për çdo nënseksion të seksioneve 2, 3,4 dhe 5 do të jepet rezultati prej 1 deri 5 si vijon: 1= shumë dobët; 2= dobët; 3=e përshtatshme; 4=mirë; 5=shumë mirë.

Tabela e vlerësimit

Përzgjedhja	
1. Kapaciteti financiar dhe operativ	Po/Jo
1.1 A kanë aplikantët , apo edhe subjektet e ndërlidhura nëse aplikohet, eksperiencë të mjaftueshme në menaxhim të projekteve?	
1.2 A kanë aplikantët , apo edhe subjektet e ndërlidhura nëse aplikohet, eksperiencë të mjaftueshme teknike? (sidomos niohuri rreth çështies që duhet adresuar.)	
1.3 A kanë aplikantët , apo edhe subjektet e ndërlidhura nëse aplikohet , kapacitet të mjaftueshëm menaxherial? (duke përfshirë stafin, pajisje dhe aftësinë për ta menaxhuar buxhetin për veprim)?	
1.4 A ka aplikanti burime financiare të qëndrueshme dhe të mjaftueshme?	
	Pikët maksimale
2. Rëndësia e veprimit	30
<i>Pikët e transferuara nga vlerësimi i Dokumentit të konceptit.</i>	
3. Efektiviteti dhe fizibiliteti në veprim	20
3.1 A janë aktivitetet e propozuara të përshtatshme, praktike dhe në pajtueshmëri me objektivat dhe rezultatet e pritura?	5
3.2 A është plani i veprimit i qartë dhe i zbatueshëm?	5
3.3 A përmban propozimi indikatorë objektivisht të ndryshëm për rezultatet e veprimit? A është ndonjë vlerësim i planifikuar?	5
3.4 A është i kënaqshëm niveli i pjesëmarrjes dhe përfshirjes së bashkë-aplikantit dhe subjekteve të ndërlidhura në veprim?	5
4. Qëndrueshmëria e veprimit	15

4.1 A ekziston mundësia që veprimi të ketë ndikim të prekshëm në grupet e synuara	5
4.2 A ekziston mundësia që propozimi të ketë efekte shumëzuese? (Duke përfshirë fushëveprimin e ripërsëritjes, zgjerimit dhe shpërndarjes së informacionit.)	5
4.3 A janë të qëndrueshme rezultatet e veprimit të propozuar?: - financiarisht (si do të financohen veprimet pasi që fondi të mbaroj?) - institucionalisht (në fund të veprimit, strukturat të cilat e bëjnë të mundur vazhdimin e aktiviteteve a do të jenë në vend? A do të jetë një “pronësi” lokale e rezultateve të veprimit? - Në nivelin politikë (nëse aplikohet) (cili do të jetë ndikimi struktural i veprimit — p.sh. a do të çojë në përmirësimin e legjislaturës, kodeve të sjelljes, metodave, etj. - mjedisore (nëse aplikohet) (a do të ketë veprimi një ndikim pozitiv apo negative në mjedis?)	5
5. Buxheti dhe efektiviteti i kostos ne veprim	15
5.1 A reflektohen veprimet në mënyrë të përshtatshme në veprim?	5
5.2 A është raporti në mes kostos së llogaritur dhe rezultateve të pritura i kënaqshëm?	5*2
Pikët maksimale	80

*këto pikë shumëzohen me 2 për shkak të rëndësisë së tyre.

Shënim për seksionin 1 Kapaciteti financiar dhe operativ

Nëse përgjigjja është negative në një ose më shumë kritere, aplikacioni do të refuzohet

Përzgjedhja e përkohshme

Pas vlerësimit do të hartohet një tabelë me listën e emrave të aplikantëve të radhitur në bazë të numrit të pikëve brenda limiteve të fondeve në dispozicion. Veç kësaj, një listë e pritjes do të hartohet nën kriteret e njëjta e cila do të përdoret në rast se fondet do të jenë në dispozicion deri sa lista e pritjes të jetë valide.

(3) Hapi 3: VERIFIKIMI I PRANUESHMËRISË SË APLIKANTËVE DHE SUBJEKTEVE TË NDËRLIDHURA

Verifikimi i pranueshmërisë, bazuar në dokumentet mbështetëse të kërkuara nga Komisioni i Përbashkët Drejtues (KPD) (shih Seksionin 2.4) do të ekzekutohet vetëm tek aplikantët të cilët kanë qenë të përzgjedhur më herët sipas pikëve të tyre dhe brenda zarfit financiar në dispozicion.

- Deklarata nga aplikanti (Seksioni 8 i Pjesës B formulari i aplikimit për grant) do të kontrollohet së bashku me dokumentet mbështetëse të siguruara nga aplikantët. Për çdo dokument që mungon apo dhe për çdo mospërputhje në mes të deklaratës së aplikantit dhe dokumenteve mbështetëse do të shpie në refuzim të aplikacionit mbi këtë bazë.
- Pranueshmëria e aplikantëve, e subjekteve të ndërlidhura dhe të veprimeve do të verifikohet në bazë të kritereve të caktuara në Seksionet; 2.1.1, 2.1.2, 2.1.3, 2.1.4 dhe 2.1.5.

Secili aplikacion i refuzuar do të zëvendësohet me aplikacionin tjetër më të mirë në listën e pritjes brenda zarfit financiar në dispozicion.

2.4 DORËZIMI I DOKUMENTEVE PËRKRAHËSE PËR APLIKIMET E PËRZGJEDHURA PËRKOHËSISHT

Një aplikant që është zgjedhur përkohësisht ose është vendosur në listën rezervë do të informohet me shkrim nga Komisioni i Përbashkët Monitorues (ose Komisioni i Përbashkët Drejtues). Nga ata do të kërkohej që të sigurojnë dokumentet e mëposhtme në mënyrë që të lejojnë të verifikohet pranueshmëria e aplikantëve, të bashkë-aplikantit (ve) dhe (nëse ka) të subjektit (ve) të tyre të ndërlidhura¹⁴:

1. Statusi apo përcaktimi i asociacionit të aplikantëve dhe (nëse ka) të secilit subjekt të ndërlidhur¹⁵

Kur Autoriteti Kontraktues ka njohur aplikantin, ose bashkë-aplikanti (tët), ose subjektin (et) e tyre të ndërlidhura pranueshmëria për një tjetër thirrje për propozime nën të njëjtën linjë të buxhetit brenda 2 viteve para afatit të fundit për pranimin e aplikacioneve, duhet të dorëzohet, në vend të statusit apo përcaktimit të asociacionit, një kopje e dokumentit që vërteton pranueshmërinë e tyre për një ish Thirrje (p.sh. një kopje të kushteve të veçanta të kontratës së grantit të pranuar gjatë periudhës referuese), përveç nëse një ndryshim në statusin ligjor ka ndodhur në ndërkohë¹⁶.

2 . Një kopje e llogarisë së fundit të aplikantit (të fitimit dhe humbjes dhe pasqyra e bilancit për vitin e fundit financiar për të cilin llogaritë janë mbyllur)¹⁷. Një kopje e llogarisë së fundit nuk kërkohej nga (nëse ka) bashkë-aplikanti (tët). Për organizatat e regjistruara në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë këto dokumente duhet të jenë të lëshuara nga Zyra Qendrore e Regjistrimit. Për organizatat e regjistruara në Kosovë dokumentet e tilla duhet të jenë të certifikuara nga një auditor i jashtëm i pavarur.

3 . Një formë e personit juridik (shih shtojcën D të këtyre Udhëzimeve) e kompletuar si duhet dhe e nënshkruar nga secili prej aplikantëve (dmth nga aplikanti dhe (nëse ka) nga secili bashkë-aplikant, e shoqëruar me dokumentet justifikuese të kërkuara aty. Nëse aplikantët kanë nënshkruar tashmë një kontratë me Autoritetin Kontraktues, në vend të formës së personit juridik dhe dokumenteve mbështetëse, numri i personit juridik mund të ofrohet, përveç nëse ndonjë ndryshim i statusit ligjor ka ndodhur në ndërkohë.

4 . Një formë e identifikimit financiar të aplikantit (jo nga bashkë-aplikanti (tët) në përputhje me modelin e bashkangjitur në Shtojcën E të këtyre Udhëzimeve, e vërtetuar nga banka në të cilën do të bëhen pagesat. Kjo bankë duhet të gjendet në vendin ku aplikanti është vendosur. Nëse aplikanti ka dorëzuar një formular identifikimi financiar në të kaluarën për një kontratë, ku Komisioni Evropian ishte përgjegjës për pagesa dhe ka për qëllim të përdorë të njëjtën llogari bankare, një kopje e formularit të mëparshëm të identifikimit financiar mund të ofrohet.

Për të gjithë aplikantët projekti it ë cilëve përfshinë kryerjen e punëve, dokumentet në vijim do të kërkohej përveç atyre të përmendura më lartë:

2. Dëshmi mbi pronësinë apo qiradhënie afatgjate (10 vite pas nënshkrimit të kontratës) së tokës /aseteve;
3. Dizajni i punëve fillestare;
4. Të gjitha autorizimet e nevojshme ligjore (psh: lokacioni dhe lejet e ndërtimit, vlerësimi i ndikimit mjedisor);
5. Fatura indikative e sasive – e kalkuluar në EUR.

Dokumentet e kërkuara mbështetëse duhet të ofrohen në formë të origjinaleve, fotokopjet apo versione të skanuara (dmth. duke treguar pulla postale të lexueshme, nënshkrimet dhe datat) të origjinaleve në fjalë. Megjithatë, Forma e Personit Juridik dhe Formulari i Identifikimi Financiar gjithmonë duhet të dorëzohen në origjinal.

Kur dokumentet e tilla nuk janë në një nga gjuhët zyrtare të Bashkimit Evropian ose në gjuhën e vendit ku është zbatuar veprimi, një përkthim në anglisht i pjesëve relevante të këtyre dokumenteve që dëshmojnë

¹⁴ Asnjë dokument mbështetës nuk do të kërkohej për aplikacionet për grant që nuk tejkalojnë EUR 60,000.

¹⁵ Kur aplikanti dhe/ose bashkë-aplikanti (tët dhe ose subjekti (tet) e ndërlidhura janë organ publik i krijuar me ligj, një kopje e ligjit të përmendur duhet të ofrohet.

¹⁶ Të shënohet vetëm nëse kushtet e pranueshmërisë nuk kanë ndryshuar nga njëra thirrje për propozime tek tjetra.

¹⁷ Ky obligim nuk aplikohet për persona fizik që kanë pranuar bursë ose që janë në nevojë të përkrahjes direkte, as për organet publike apo organizatat ndërkombëtare. Nuk vlen as kur llogaritë janë në praktikë dokumentet e njëjta si raportet e auditorit tashmë të ofruara sipas Seksionit 2.4.2.

pranueshmërinë e aplikantit (ve), duhet të bashkëngjitet dhe do të mbizotërojë me qëllim të analizimit të aplikimit.

Ku këto dokumente janë në një gjuhë zyrtare të Bashkimit Evropian përveç anglishtes, atëherë rekomandohet fuqimisht, për të lehtësuar vlerësimin, të sigurohet një përkthim i pjesëve përkatëse të dokumenteve, duke dëshmuar pranueshmërinë a aplikantëve, në anglisht si gjuhë e Thirrjes për Propozime.

Nëse dokumentet e lartpërmendura mbështetëse nuk janë siguruar para afatit të treguar në kërkesën për dokumente mbështetëse dërguar aplikantit nga Autoriteti Kontraktues, kërkesa mund të refuzohet.

Pas verifikimit të dokumenteve mbështetëse, Komisioni i Vlerësimit do të bëjë një rekomandim përfundimtar për Komisionin e Përbashkët Drejtues / Autoritetin Kontraktues i cili do të vendosë për dhënien e granteve

2.5 NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

2.5.1 Përmbajtja e vendimit

Aplikanti do të informohet me shkrim nga Komisioni i Përbashkët Monitorues (apo Komisioni i Përbashkët Drejtues) mbi vendimin e aplikimit të tyre dhe në rast të refuzimit, arsyetimi për vendimin negativë.

Aplikantët që besojnë se janë dëmtuar nga ndonjë gabim apo parregullsi gjatë procesit të dhënies së grantit, mund të paraqesin ankesë. Shih më gjerësisht Seksionin 2.4.15 të Udhëzimit Praktikë.

2.5.2 Orari i ndikativ kohor		
	DATA	KOHA
Sesioni informativ	Referoju 2.2.4	-
Afati i fundit kohor për kërkimin e sqarimeve nga Autoriteti Kontraktues	30 dhjetor 2013	-
Data e fundit në të cilën sqarimet jepen nga Autoriteti Kontraktues	9 janar 2014	-
Afati i fundit kohor për dorëzim të aplikacionit	20 janar 2014	16:00 CET
Informata për aplikantët mbi kontrollimin administrative dhe të hapjes dhe vlerësimi të Dokumentit të Konceptit (hapi 1)	shkurt/mars 2014	-
Informata për aplikantët lidhur me vlerësimin e Formularit të Plotë të Aplikimit	prill/maj 2014	-
Njoftimi mbi dhënien e grantit (pas kontrollit të pranueshmërisë) (hapi 3)	maj 2014	-
Nënshkrimi i Kontratës	qershor 2014	-

* Informata specifike mbi datat dhe vendet do të publikohen në të njëjtat ueb faqe sikur këto udhëzime

** Data e përkohshme Të gjitha kohët janë sipas zonave të vendit të Autoritetit Kontraktues

Kjo tabelë indikative mund të azhurnohet nga KPD gjatë procedurës. Në rast të tillë tabela e azhurnuar do të publikohet në uebfaqen e Ministrisë për Vetëqeverisje Lokale në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë: www.mls.gov.mk, dhe në uebfaqen e Ministrisë për Qeverisje Lokale dhe Administratë në Kosovë <http://mapl.rks.gov.net>, si dhe në uebfaqen e EuropeAid në <https://webgate.ec.europa.eu/europeaid/online-services/index.cfm?do=publi.welcome>

2.6 KUSHTET PËR IMPLEMENTIM PAS VENDIMIT TË AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN E GRANTIT

Pas vendimit për dhënie e një granti, Përfituesit(ve) do t'i ofrohet një kontratë e bazuar në kontratën standarde për grant të Autoritetit Kontraktues (shih Shtojcën G të këtij Udhëzuesi). Me nënshkrimin e Formularit për Aplikim (Shtojca A e këtij Udhëzuesi), aplikuesi pajtohet, në qoftë se i jepet granti, që të pranoj kushtet kontraktuale të kontratës standarde të grantit.

Kontratat e implementimit

Në rastin kur implementimi kërkon që Përfituesi(t) dhe entiteti(et) i tij vartës(e) (nëse ka) të lidhë kontrata prokurimi, atëherë kontrata i duhet dhënë tenderuesit që ofron vlerën më të mirë për paratë, që do të thotë, raportin më të mirë mes çmimit me cilësinë, në përputhje me parimet e transparencës dhe trajtimit të barabartë të kontraktorëve të mundshëm, kështu duke u kujdesur që të shmanget ndonjë konflikt i interesave. Për këtë qëllim, Përfituesi duhet të ndjekë procedurat e përcaktuara në Shtojcën IV të kontratës standarde të grantit.

2.7 SISTEMI I PARALAJMËRIMIT TË HERSHËM DHE BAZA E TË DHËNAVE QENDRORE TË PËRJASHTIMIT

Aplikuesit dhe, në qoftë se ata janë persona juridik, personat që kanë kompetencat e përfaqësimit, vendim-marrjes ose kontrollit mbi ta, informohen se, në qoftë se janë në njërin prej situatave të përmendura në:

- Vendimin e Komisionit të datës 16.12.2008 në Sistemin i Paralajmërimit të Hershëm (SPH) për përdorimin e zyrtarëve autorizues të Komisionit dhe agjencive ekzekutive (OJ, L 344, 20.12.2008, f.125) apo

- Rregulloren e Komisionit të datës 17.12.2008 mbi Bazën e të Dhënave Qendrore të Përfundimit (BDhQP) (OJ L344, 20.12.2008, f.12),

të dhënat e tyre personale (emri, emri i dhënë (nëse është person fizik), adresën, formën ligjore dhe emrin si dhe emrin e dhënë të personave me kompetenca të përfaqësimit, vendim-marrjes ose kontrollit, (nëse është person juridik)) mundë të regjistrohen vetëm në SPH ose në të dyja në SPH dhe BDhQP, dhe i komunikohen personave dhe subjekteve të listuara në Vendimin dhe Rregulloren e lartpërmendur, në lidhje me dhënie ose ekzekutimin e një marrëveshjeje apo vendimi për grant.

3. LISTA OF ANEKSEVE

DOKUMENTET QË DUHET TË KOMPLETOHEN

Aneksi A: Forma e Aplikimit për Grant (në Word)

Aneksi B: Buxheti (në Excel)

Aneksi C: Korniza Logjike (në Word)

Aneksi D: Forma e Personit Juridik

Aneksi E: Forma e identifikimit financiar

DOKUMENTET PËR INFORMATË

Aneksi G: Kontrata Standarde e Grantit
Kushtet e veçanta të kontratës së grantit

- Aneksi II: Kushtet e përgjithshme të aplikueshme për grantet e financuara nga Bashkimi Evropian për veprime të jashtme
- Aneksi IV: Procedurat e dhënies së kontratës
- Aneksi V: Kërkesa standard për pagesë
- Aneksi VI: Modeli i raportit narrative dhe financiar
- Aneksi VII: Modeli i raportit me të gjeturat faktike the termet e referencës për verifikim të shpenzimeve të grantit të financuar nga BE për veprime të jashtme
- Aneksi VIII: Modeli i Garancionit Bankar
- Aneksi IX: Shablloni standard për transferim të pronësisë së asetve

Aneksi H: Norma ditore (mëditja), në dispozicion në adresën ën vijim
http://ec.europa.eu/europeaid/ëork/procedures/implementation/index_en.htm

Aneksi K: Udhëzimet dhe lista e kontrollit për vlerësim të Buxhetit dhe mundësia e thjeshtuar i kostos.

Aneksi J: Informata mbi regjimin e taksave i aplikueshëm për kontratat e grantit të nënshkruara për këtë thirrje

Udhëzimet për Menaxhim të Ciklit të Projektit
http://ec.europa.eu/europeaid/multimedia/publications/publications/manuals-tools/t101_en.htm

Udhëzimet e BE-së për Vizibilitetin:
EN: http://ec.europa.eu/europeaid/ëork/visibility/index_en.htm